



Vjetar informativ i
Departamentit të Antropologjisë
Fakulteti Filozofik,
Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina"
Gusht 2021 / Nr. 3



Letra e redaksisë

Këtë vit Departamenti i Antropologjisë mbush 20 vjet. Në krahasim me departamentet e tjera, në rajon e më gjerë, është mjaft i ri. Brezi i parë i etnologëve, të cilët kishin vënë themelet e punës etnologjike, Kadri Halimi e Mark Krasniqi, u diplomuan në vitet 1950, jashtë Kosovës. Fatkeqësisht, Kadri Halimi u akuzua për veprimtari politike kundër regjimit dhe u burgos, Mark Krasniqi u akuzua për nacionalizëm në vitet 1960 dhe u përjashtua nga UP-ja, në vitet 1980. Por, puna e etnologëve shqiptarë vazhdoi: Mark Krasniqi dhe brezi i dytë i etnologëve/gjeografëve të trajnuar edhe jashtë Kosovës (Drita Halimi-Statovci, Ukë Xhemaj, Bashkim Lajçi, etj.) vazhduan punën etnologjike.

Në aspektin institucional, Departamentit të Antropologjisë, i kanë paraprirë disa institucione të cilat kanë profilizuar punën etnologjike. Muzeu i Kosovës u themelua në vitin 1949, ndërsa Instituti Albanologjik u themelua në vitin 1953, dhe pas mbylljes e rihapjes më 1967, në vitin 1970, nxori seksionin "Folklor dhe etnologji" në kuadër të revistës "Gjurmime Albanologjike" e në vitin 1974 u formua edhe "Sektori i Etnologjisë", si degë në kuadër të IAP-it. Po ashtu, lënda "Etnologji" hyri në kurrikulën e Departamentit të Historisë në Fakultetin Filozofik në vitin 1994. Tek pas luftës së viteve 1998-99, në vitin 2001, u themelua Departamenti i Etnologjisee, me

iniciativë të Prof. Dr. Drita Halimi-Statovcit. Sot, ky departament ka marrë formë të re, si në përmbajtje të kurrikulës, ashtu edhe në politika hulumtimi e kahe të mendimit e shqyrtimit antropologjik. Po ashtu, pas disa akreditimeve nga Agjencia e Kosovës për Akreditim., Departamenti i Antropologjisë ka hapur shtigje të reja programe, duke akredituar dy drejtime në programin BA: Antropologji kulturore dhe Arkeologji. Në kuadër të bashkëpunimeve me institucione të tjera janë realizuar një sërë projektsh të sukseshshme, disa prej të cilave ende vazhdojnë. Në vitin e ardhshëm synohet akreditimi i një programi të ri (MA), me fokus në antropologji të trashëgimisë kulturore.

Një numër i ish-studentëve kanë vazhduar studimet dhe punën jashtë vendit, e një numër i konsiderueshëm prej tyre janë punësuar në sektorët përkatës në Kosovë. Disa nga kolegët e Departamentit janë avancuar në thirrje akademike, disa kanë botuar libra e shkrime të ndryshme, disa të tjerë kanë nisur projekte të reja hulumtuese.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, Departamenti i Antropologjisë, sikur edhe departamentet e tjera në Fakultetin Filozofik në UP, ka qenë i sfiduar nga mësimi virtual përmes Internetit. Mësimi virtual nuk është i njëjtë si mësimi dhe studimi në kampus. Megjithatë, Departamenti

ka gjetur disa mënyra për të freskuar rutinën e zakonshme të ligjëratave përmes Internetit. Me zbutjen e masave kundër COVID 19, sidomos në muajt prill dhe maj, profesorët e Departamentit kanë organizuar një sërë vizitash në terren, duke u larguar nga rutina e lodhshme e mësimi përmes Internetit.

Për të ditur më shumë për këto tema që përmendëm më lart, duhet të shfletoni vjetarin AA dhe ta lexoni atë.

Departamentin e presin punë të reja – punë këto që kërkojnë vullnet për bashkëpunim. Së bashku me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët, po krijohet një klimë e mirëfilltë e studimit antropologjik.

Falënderojmë të gjithë profesorët, studentët, administratorët dhe të gjithë të tjerët që kanë ndihmuar në themelimin dhe ngritjen e Departamentit të Antropologjisë.

Urime 20 vjetorin e themelimit të Departamentit!

Arsim Canolli

AA, Nr. 3, Gusht, 2021

Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Redaksia: Arsim Canolli (kryeredaktor - arsim.canolli@uni-pr.edu); Arben Hajdari (redaktor - arben.hajdari@uni-pr.edu);

Tahir Latifi (redaktor dhe lektor - tahir.latifi@uni-pr.edu). Del njëherë në vit, në formë të shtypur dhe digjitale.

(Ballina © fotografuar nga Mirishahe Sylja, ndërsa në kostume të Zymit të Hasit është studentja e antropologjisë Miridonë Sylja)



INFO & AKTIVITETE

Mirënjohje për Diora Arifin, studente e antropologjisë kulturore

Në përvjetorin e 51-të të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", rektori Prof. Dr. Naser Sahiti, ndau mirënjohje për studentët e dalluar të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës. Ndër ta, mirënjohje mori edhe Diora Arifi, studente e vitit të tretë, në programin "Antropologji kulturore", të Departamentit të Antropologjisë.



Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari nderohet nga Franca me çmimin "Palma akademike"



Në korrik të vitit 2021, profesori i arkeologjisë në Departamentin e Antropologjisë, Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari u nderua me çmimin e lartë për arritje akademike "Palmes académiques" (Chevalier), që u jepet personaliteteve akademike. Profesor Hajdari bashkëudhëheq projektin arkeologjik 3 vjeçar të gërmimeve në Ulpianë, si projekt mes tri institucioneve: Ecole Normale Supérieure, Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", i financuar nga Bashkimi Evropian. Çmimi iu dha në kuadër të organizimit solemn për festën kombëtare të Francës, më 14 korrik, nga ambasadorja e Francës në Kosovë, Mme Marie-Christine Butel. Departamenti i Antropologjisë përgëzon prof. Arben Hajdarin dhe i uron suksese të mëtejshme akademike në fushën e arkeologjisë.

Profesorët dhe studentët e antropologjisë nderohen me çmimin "Shtjefën Gjeçovi" në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore

Në shkurt të vitit 2021, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës nderoi ekipin realizues të projektit të historisë gojore "Kujtesa e Kosovës: rrëfime të 100 pleqve e plakave të Kosovës" (10 vëllime) me çmimin vjetor "Shtjefën Gjeçovi" për merita të veçanta në fushën e trashëgimisë kulturore. Ky projekt që realizuar gjatë viteve, 2017-2020, nga studentët e Departamentit të Antropologjisë: Iliriana Blakaj, Bjeshkë Guri, Teutë Ahmeti, Fjolla Thaçi, Arbnora Kolgjera, Fisnik Kamberi, Egzona Azemi, Albiona Basha, Anduena Halilaj, Ardian Ademi, Andoneta Selimi, Edita Qerimi, Lekë Shala, Marigona Dubovci, Batije Sylejmani. Projekti u mbikëqyr nga profesorët e Departamentit të Antropologjisë: Ukë Xhemaj dhe Arsim Canolli, por edhe nga punëtorët e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. "Pjetër Bogdani". Çmimi u nda për gjithë grupin punues përfshirë edhe stafin e BKK-së.

Një projekt i përbashkët i Departamentit të Antropologjisë dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dokumenton masakrën e Krushës së Madhe

Në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm mes Departamentit të Antropologjisë dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” – Qendra Kujtesa e Kosovës, po realizohet projekti “KUJTESA e KOSOVËS: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”.

Ky projekt synon të mbledhë, dokumentojë, publikojë dhe të ruajë rrëfimet e të mbijetuarve dhe dëshmitarëve okularë të masakrës së Krushës së Madhe, të komunës së Rahovecit, në Kosovë. Në tërësi, do të realizohen deri në treqind [300] intervista të historisë gojore (audio dhe video), si dhe do të mbledhen dëshmi dhe materiale të tjera relevante që dokumentojnë masakrën e Krushës së Madhe, në mënyrë që të zgjerohen njohuritë për këtë masakër dhe të kuptohen më mirë pasojat që ka lënë te të mbijetuarit.

Projekti menaxhohet nga Gresë Maliqi, zyrtare e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe mentorohet nga Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli, Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi dhe Dr. Tahir Latifi. Intervistat me të mbijetuarit dhe dëshmitarët e masakrës janë duke u realizuar nga hulumtuesit e përzgjedhur të projektit, një numër i madh i tyre janë studentë ose të diplomuar në Departamentin e Antropologjisë. Të gjithë intervistuesit u janë nënshtruar trajnimeve profesionale të mentorëve të projektit, profesorëve e profesionistëve të tjerë



vendës dhe profesorëve të historisë gojore nga SHBA-të.

Projekti synon të bëjë dokumentimin e rrëfimeve për masakrën e Krushës së Madhe nga të mbijetuarit dhe dëshmitarët e masakrës.

Sipas planit të paraparë me projekt:

- do të realizohen 250 - 300 intervista (audio dhe video) me të mbijetuarit dhe dëshmitarët e masakrës,
- do të bëhet transkriptimi i tyre autentik,
- do të përkthehen në gjuhë angleze dhe serbe,
- do të publikohen të gjitha të transkriptuara dhe në video të titruara shqip, anglisht dhe serbisht

- do të ruhen në arkiv e botohen në uebfaqe të institucioneve relevante për qasje publike

Të gjitha intervistat do t'i përkasin domenit publik, ku mund t'u qaset publiku i gjerë. Biblioteka Kombëtare e Kosovës do të krijojë hapësirë specifike në uebfaqen e saj për ruajtjen e tyre.

Projekti mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës dhe përkrahet edhe nga komuna e Rahovecit dhe Ambasada Amerikane në Kosovë. Projekti pritet të përfundojë në nëntor të vitit 2022.

Studentë e antropologjisë bëjnë punë praktike në RTV21

Në semestrin e gjashtë (mars-maj 2021), studentët e vitit të tretë të antropologjisë kulturore kanë bërë punë praktike në televizionin kombëtar RTV21. Në kuadër të studimeve në lëndën “Media dhe kultura”, të ligjëruar nga Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani, studentët kanë realizuar punën praktike në këtë televizion, ku, mes tjerash, janë trajnuar se si të punojnë në fushën e medieve profesionale. Disa nga punët praktike të studentëve kanë qenë: hulumtimi dhe shkrimi i lajmeve, njohja me prezantimin në programe televizive, procesi i redaktimit e punë të tjera përkatëse.



Puna praktike e studentëve është realizuar në kuadër të bashkëpunimit mes Institutit për Studime Sociale e Humanistike të Fakultetit Filozofik me RTV21.

Fondi dhe ekspozita “Kujtesa kulinare” – projekt mes Departamentit të Antropologjisë dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës

Në dhjetor të vitit 2020, Departamenti i Antropologjisë, dorëzoi fondin prej 100 menyve të restoranteve të Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Ky fond u mbledh nga profesor Arsim Canolli dhe studentët e antropologjisë gjatë viteve 2016-2020. Studentët të cilët kanë kontribuar në mbledhjen e menyve janë: Marigona Dubovci, Lekë Shala, Albiona Selmanaj, Teutë Ahmeti, Flakrina Maloku, Andoneta Selimi dhe Edita Qerimi. Fondi i menyve i krijuar në BKK është ftesë për të pasuruar fondin e kujtesës së trashëgimisë kulinare të Kosovës me meny, receta, libra gatimi, tv-emisione kulinare, dokumentarë kulinarë, katalogje ushqimi, materiale promovuese gastronomike, rrëfime kulinare, tregime mbi shijen, receta e rrëfime të mjekësisë popullore dhe forma e praktika të tjera të kujtesës e trashëgimisë kulinare të Kosovës. Departamenti i Antropologjisë do të vazhdojë bashkëpunimin me BKK-



në për të pasuruar këtë fond, të nevojshëm për të studiuar kulturën e bukës si histori e trashëgimi kulturore e Kosovës.

Në kuadër të Javës së Bibliotekës (24-30 maj 2021), BKK botoi katalogun “Kujtesa kulinare: meny të e restoranteve të Kosovës” të përgatitur nga Arsim

Canolli dhe hapi një ekspozitë me këto meny. Po ashtu, u organizua edhe një panel diskutimi “Kujtesa, trashëgimia dhe kulinaria”, ku u diskutua për kulturën kulinare të Kosovës, nga studiues, gastronomë e shefë kuzhine.


Studentët e antropologjisë dokumentojnë praktikat kulinare të Kosovës

Disa studentë të antropologjisë kulturore kanë marrë pjesë në projektin “Food on our tables: documenting culinary practices in Kosovo” (shkurt-prill 2021), në kuadër të organizatës “Kosovo calling ethnography project”, të financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë, të cilin e udhëheq antropologu Arbër Jashari. Ata kanë dokumentuar vizuelisht praktika të ndryshme kulinare, prej pjekjes së bukës e deri te prodhimi i rakisë. Dokumentimi i këtyre praktikave pritet të jetë i qasshëm për publikun, së shpejti, në një uebfaqe specifike.

THE FOOD ON OUR TABLES

documenting culinary practices in Kosovo

22-28 february 2021




HERAS+: “Historical demography in Kosovo”

Në bashkëpunim me Universitetin e Graz-it (Austri), Departamenti i Antropologjisë është fitues i një granti nga HERAS+ për hulumtimin e të dhënave historike-demografike. Tema e projektit është “Historical demography in Kosovo”. Burimet e mundshme të të dhënave janë dokumente nga administratat shtetërore: dorëshkrime të regjistrimeve të popullsisë, lista tati-more, regjistra të popullsisë; dokumente nga administratat fetare: kishtare dhe të xhamive – ngjarjet jetësore, lindjet, martesat, vdekjet. Këto të dhëna përfshijnë të gjithë popullsinë e evidentuar të një zone të caktuar: burra dhe gra, persona të rritur dhe fëmijë. Të dhënat e përfshira janë ato të individëve sipas njësive të banimit, respektivisht familjeve. Këtu përfshihen të dhëna për emrin, gjininë, moshën, emrin e të zotit të shtëpisë, statusin/statuset martesore të anëtarëve të familjes, vendin dhe vitin e regjistrimit. Përveç këtyre, të dhënat e mundshme përfshijnë edhe përkatësinë etnike, fetare, profesionin, pasurinë, të ardhurat dhe pagesat e taksave.

Projekti ka filluar në qershor 2021 dhe zgjat deri në dhjetor të vitit 2022. Partner në implementim të projektit janë: 1) Koordinator: Universiteti i Graz-it – menaxher, Dr. Siegfried Gruber; 2) Universiteti i Prishtinës është partner 1, me Dr. Tahir Latifi dhe si hulumtuese e re/asistente Egzona Azemi, e diplomuar në Departamentin e Antropologjisë; 3) Universiteti i Tiranës, Partner 2, me Dr. Gentiana Kera.

Asistentja Zanita Halimi doktoron në Vjenë të Austrisë

Asistentja e Departamentit, Zanita Halimi doktoroi në antropologji kulturore në Universitetin e Vjenës me temë “Fotografia familjare si konstrukt i kujtesës familjare në Kosovë”, Dr. Zanita Halimi është ndër mësimm-dhënëset e para në Departament. Ajo ka vijuar studimet në Departament, si studente e gjeneratës së parë (2001-2004) dhe pastaj ka filluar të punojë si asistente në lëndët e antropologjisë kulturore që nga viti 2007. Departamenti i Antropologjisë e përgëzon Zanitën dhe i dëshiron suksese të mëtutjeshme në karrierën e saj akademike!



Kullat si trashëgimi shpirtërore



Departamenti i Antropologjisë ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin Kosovar “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” (CHwB Kosova) për hulumtimin dhe dokumentimin e vlerave shpirtërore të kullave në Rrafshin e Dukagjinit.

Ky hulumtim, që realizohet si projekt i ILUCIDARE dhe financohet nga Bashkimi Evropian, udhëhiqet nga Universiteti i Leuven-it, në partneritet me Europa Nostra, KEA European Affairs, International Cultural Centre-World’s Monuments (Spanjë).

Në realizimin praktik të hulumtimit dhe dokumentimit të vlerave shpirtërore të kullave marrin pjesë 7 studentë nga Departamenti i Antropologjisë dhe 2 nga Departamenti i Sociologjisë, të cilët, gjatë periudhës së ekspeditës së korrikut, kanë realizuar mbi 40 intervista me banorë lokalë në disa lokalitete të Rrafshit të Dukagjinit. Studentët që kanë marrë pjesë në projekt janë: Çlirimtare Januzaj, Valentina Krasniqi, Ardita Aliu, Elza Krasniqi, Labeat Elsha-

ni, Miridona Sylja, Arlinda Shatri, Ridona Berisha, Egzona Hajrullahu.


Hulumtimi empirik udhëhiqet nga dy koordinatorë: Dr. Tahir Latifi nga Departamenti i Antropologjisë dhe Dr. Lumnije Kadriu nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, institucion ky partner në realizimin praktik të këtij projekti.

Rezultatet e projektit pritet të paraqiten dhe diskutohen në një konferencë shkencore që do të mba-



Netët e Filmit Online

Zanita Halimi



Gjatë periudhës së pandemisë, atëherë kur ne takoheshim për ligjërata dhe ushtrime në mënyrë virtuale me studentë dhe, duke pasur parasysh faktin që studentët e vitit të parë nuk njiheshin fare mes veti, lindi ideja për netët e filmit online. Një hapësirë dialogu për antropologjinë, terrenin, film-bërjen, teorinë përmes shikimit të përbashkët të filmave të ndryshëm etnografikë. Në të njëjtën kohë, në hapësira të ndryshme familjare, studentët kanë pasur mundësinë që të shikojnë filma, të diskutojnë së bashku me profesorët dhe kolegët e tyre, në kuadër të netëve të filmit online. Kjo mënyrë, ishte si një freski në ditët e pandemisë dhe, po ashtu, i ndihmoi studentët të komunikojnë më shumë mes vete, si dhe të mësojnë më tepër për antropologjinë.

Pra, Programi i Etnografisë Vizuale, në kuadër të netëve të filmit online, ka shfaqur filma të ndryshëm etnografikë, duke filluar nga filmi Margaret Mead: Taking note nga Anne Peck, Albanians of Rrogam nga Berit Backer, Në mes nga Samir Karahoda, i cili ishte prezent dhe bashkëbisedoi me studentë për filmin e tij, Dasma dhe Pampersat nga Andoneta Kastrati, Daullet e

Rezistencës nga Mathieu Jouffre dhe Besa Luci. Po ashtu, u shfaqën edhe tre dokumentarët e studentëve Anduena Halilaj dhe Lekë Shala, Kroni i Goruzhipit, Urtesë Zeneli dhe Nol Berisha Vija e hollë e çelikut dhe Shpat Shkodar e Yll Bylykbashi Offside. Në bashkëpunim me Institutin për Antropologji Kulturore dhe Studime të Artit, ata ishin prezentë dhe patën rastin të diskutojnë më kolegë të tjerë për punën e tyre. Disa nga komentet e studentëve për këtë aktivitetet.

“Po, shfaqja e filmave etnografikë ka qenë pjesa më relaksuese dhe më e kandshme e javës. Kemi pas rastin po ashtu me bashkëbisedu edhe me krijuesit e filmave dhe ka qenë shumë privilegj. Shumica e filmave etnografikë ishin bashkëdizim i të gjitha informacioneve që kishim për etnografinë, për terrenin dhe për mënyrën e jetesës. Më zgjuan posaçërisht kureshtjen e sinkronizimit të zërit dhe qetësisë, të shpirtërores dhe hamendjes, ndoshta flitej pak, por, kishte kujtime të mëdha dhe që kishin zë të pa'shterrun ende. Filmat nuk ishin asnjëri i njëjtë nga tjetri, por kishin

të njëjtën frymë etnografike, e cila te zgjonte kureshtjen, të besojë që ka një jetesë të ndryshme në çdo cep dhe diversitet holistik. Me falënderime të përzemërta për gjithë profesorët për kontributin e dhënë, edhe për netët e filmit që ishte kandi më divers për diskutime dhe më i lezetshmi!” (Arlinda Shatri, Viti i parë, Departamenti i Antropologjisë)

“Unë i kam ndjekur të gjitha shfaqjet online dhe, përshtypja ime është kjo: një student i antropologjisë medoemos duhet të dijë të shkuarën, ta njoh të tashmen dhe ta bëjë lidhshmërinë apo krahasimin e kulturës, qoftë ajo shekullore apo disa vjeçare. Andaj këto dokumentime online e kanë rolin e vet të pazëvendësueshëm, ngase, secili mund t'i perceptojë sipas mënyrës së vet dhe të japin më shumë ide për ngjarjet apo ndodhitë e kohës... Me fjalë tjera, tek unë, këta filma kanë ndiku shumë mirë, sepse shihet mënyra e jetesës, mendimi që kanë pas për jetën dhe ngjarjet e asaj kohë, transformimin e kulturës, lidhshmërinë e saj dhe që ne të jemi të gatshëm nesër ta përcjellim brez pas brezi.” (Mentor Azemi viti i parë, Departamenti i Antropologjisë)

E ardhmja duke e rrëfyer të kaluarën

Në qershor të vitit 2021, në Fakultetin Filozofik, u hap ekspozita “Arka: e ardhmja duke rrëfyer të kaluarën”, ekspozitë kjo e studentëve të vitit të tretë të Departamentit të Antropologjisë. Në këtë ekspozitë u prezantuan artefakte të mbledhura në krahinat shqiptare të Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Studentët prezantuan prejardhjen dhe funksionin e artefakteve, rrëfinin për kohën kur ishin krijuar e përdorur. Arditë Aliu trajtoi tri artefakte: arkën e nusërisë së familjes Prespa nga Nakoleci i Maqedonisë Veriore, veshjen e Malësisë së Madhe dhe xhubletën e vajzërisë së shqiptarëve të Malit të Zi. Në ekspozitë morën pjesë këta studentë: Artan Demaj, Diona Arifai, Diona Arifi, Endrit Hoxha, Era Draga, Elza Krasniqi, Kastriot Tahiri, Kaltrina Restelica, Arditë Aliu, Valentina Krasniqi, Albin Halimi, Lorena Kozhani, Petrit Jusufi dhe Endrita Muqa. Për ekspozitën në fjalë, profesori Arsim Sinani thotë: ky është reflektim i punës me studentë duke trajtuar aureolën kulturore shqiptare. Studentja Diona Arifi tregon se studentët e antropologjisë dallojnë sepse i bashkojnë shqiptarët nga të gjitha trojet, pastaj edhe prejardhja e tyre ndikon që të njihet kultura shqiptare më mirë. E Artan Ademaj mendon se me këtë ekspozitë kanë dashur të vendosin në vëmendje atë pjesë të harruar të krahinave shqiptare, pasi që, duke rikujtuar të kaluarën ndërtohet e ardhmja.

Kjo ekspozitë u organizua nga Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike, në bashkëpunim me Këshillin e Studentëve në Fakultetin Filozofik.



Vizitë studimore në Maqedoninë e Veriut

Bashkë me profesor Arsim Sinanin, që ligjeron dhe për trashëgiminë kulturore në raport me mjedisin, studentët e vitit të tretë të antropologjisë kulturore qëndruan në një vizitë tregitore në disa fshatra të Maqedonisë Veriore. Në kuadër të ekspeditës “Oeneum 2021”, e cila kishte synim të evidentojë jetën e përditshme aty, studentët vizituan fshatin Sallarevë, ku trajtuan trashëgiminë natyrore të liqenit të Kozjakut, që shtrihet mbi Malësinë e Malit të Thatë dhe disa fshatra të tjera: Bozovcë, Veshallë, Shipkovicë, Rasa e Dishës, Lisec - Kodra e Diellit.

Vizita studimore është realizuar nga Instituti i studimeve Sociale e Humanistike (ISSH) i Universitetit të Prishtinës, i cili drejtohet nga profesori Arsim Sinani.



Studentët e antropologjisë takuan dy rapsodët tetovarë, Jashar dhe Hydajet Sejdiu

Themelimi i Muzeut Etnologjik në Gjilan

Zanita Halimi

Saraji i Hysen Pashës në Gjilan që ndërtuar në vitin 1887. Ky objekt ka ndërruar funksion dhe për një kohë ka shërbyer si shkollë fillore, shkollë ekonomike, e më vonë edhe si shkollë muzike. Është një ndër objektet e njohura të Gjilanit, sepse shquhet për kreativitetin e ndër-tuesit në përpunimin e brendësisë së tavaneve, të cilat janë të ruajtura mjaft mirë edhe sot. Në ditën ndërkombëtare të muzeve më 18 Maj 2021 kësaj ndërtese i është ndërruar destinacioni. Në këtë ndërtesë është hapur Muzeu Etnologjik në kuadër të Projektit "Përmirësimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes thirrjes për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, nën IPA II "Programi i bashkëpunimit ndërkufitar" implementuar nga Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Kumanovës.

Së bashku me ish studentë të departmentit të Antropologjisë (Andoneta Selimi, Edita Qerimi, Donat Billaca dhe Bardha Hoxha) u angazhuam në të gjitha fazat e procesit të punës për hapjen e Muzeut Etnologjik. Puna në terren, hulumtimet në arkiva, mbledhja e artefakteve, trajtimi i tyre, procesi i inventarizimit, shkrimi i teksteteve dhe përgatitja e katalogut, janë disa nga punët që na kanë shoqëruar në këtë rrugëtim. Bashkëpunimi ishte shumë i mirë, duke pasur parasysh faktin se ky muze për ta do të jetë edhe vend pune për t'u dhënë qytetararëve të Gjilanit



njohurinë për trashëgiminë kulturore e shpirtërore të këtij vendi.

Pra, pas diskutimit të gjerë, kemi vendosur që Muzeu Etnologjik në Gjilan të jetë muze i dialogut, i hapur, aktiv dhe mikpritës, kështu shërbimit të publikut. Në këtë muze paraqitet kultura tradicionale materiale dhe shpirtërore e jetesës së përditshme, por edhe asaj festive. Në këtë muze janë të ekspozuara eksponate të pasura, që informojnë dhe komunikojnë me publikun për veprimtarinë ekonomike, për veglat e punës, veshjet, zejet e ndryshme, artin tradicional, për muzikën, për besime e rituale të ndryshme.

Në hyrje të Muzeut është edhe një kioskë suveniresh, vend i mbushur me punime dore të punuara nga Qendra Artizanale e Gjilanit, ku secili vizitor mund të blejë një dhuratë, si kujtim nga ky vend.

Në këtë hapësirë janë të prezantuara dhe materiale të tjera vizuale, të cilat prezantojnë një pjesë të trashëgimisë sonë të begatë kulturore. Secili eksponat në muze komunikon për lashtësinë, traditën dhe transformimin. Në këtë hapësirë ndiejmë simbolikën e eksponateve, përjetojmë traditën e të bukurën, komunikimet ndërkufitare, mjështërinë e krijimtarisë, mbi të gjitha mësojmë për vlerën kulturore, që na fton ta njohim e të mos e harrojmë.

Pra, Muzeu Etnologjik në Gjilan do të shërbejë edhe për punë praktike për studentët e ardhshëm të Departmentit të Antropologjisë si rritje e përbashkët e tyre.

Seminari i Antropologjisë

Nita Luci & Ilir Culaj

Antropologjia dhe Ambienti: Ndërthurje, Krizë, Veprim

Ideja për natyrën është ide për njeriun
... ide për njeriun në shoqëri,
në të vërtetë ide për llojet e shoqërisë

Raymond Williams 1980



Edicioni i tretë i Seminarit të Antropologjisë u titullua Antropologjia dhe Ambienti: Ndërthurje, Krizë, Veprim dhe, me këtë fokus tematik, e vazhduam synimin tonë që Seminari të krijojë mundësi për prezantimin, diskutimin dhe zhvillimin e mendimit antropologjik dhe arkeologjik në hapësirat tona kërkimore dhe akademike. Kësaj radhe e rimenduar hapësirën e veprimit dhe rrjetëzimit, duke përfshirë qasje të larmishme teorike dhe metodologjike dhe, duke sjellë njohje nga dhe për Kosovën dhe Rumaninë, Tanzaninë dhe Shqipërinë, Perandorinë Otomane, Venedikun dhe Dardaninë. Me një gamë të gjerë temash, që përfshijnë kultivimin e ushqimit, rrjetet dhe infrastrukturën ujore, panelet solare dhe termocentralet, politikat shtetërore, relacionet e specieve, ishujt lëvizës dhe lëvizjet shoqërore - kjo seri e Seminarit

po zbërthen studime mbi historitë, praktikën, strukturat dhe kuptimet socio-kulturore kundrejt natyrës. Veçanërisht, po përpiqemi të identifikojmë dhe kuptojmë rimendimet e përkufizimet e vazhdueshme që i bëhen natyrës dhe relacioneve tona socio-kulturore, në botën të cilën jetojmë dhe krijojmë.

Bindjeve dhe emocionit tonë se sa qendrore është antropologjia për ta kuptuar dhe formësuar të ardhmen tonë, i bashkëngjiten edhe të tjerët, jo vetëm në akademi, por edhe në qarqet ekonomike dhe politike, ku vazhdon të afirmohet nevoja për vështrim dhe njohje nga poshtë-lartë. Tashmë është bërë e qartë nevoja e ballafaqimit me transformimet e mëdha ambientale. Pandemia COVID-19, temperaturat e larta të verës 2021, shkrirja e akullnajave, zjarret në dhjetëra vende të globit, i janë bashkëngjitur listës së vazhdueshme të kizave të cilat po i

përfetojmë. Pasojat e ngrohjes globale vërehen në të gjitha rrafshet e jetës – politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore – dhe paraqesin probleme të cilat kërkojnë trajtim epistemologjik dhe politik. Arturo Escobar (1999), më shumë se para 20 viteve, na bëri të konsiderojmë se “kriza e natyrës” është edhe krizë e identitetit të natyrës. Që nga Leslie White (1949), i cili e konsideroi energjinë çelës për të kuptuarit e kulturës dhe shoqërisë dhe, rrjedhimisht relacionin e shoqërive njerëzore me natyrën, e deri te diskutimet bashkëkohore mbi nocionet si Antroposena, pluriversi, Klutusena, etj. rëndësia e vështrimeve antropologjike në akademi, specifikisht, ashtu edhe në shoqëri, më gjerësisht, mbart në vete ndërthurjen e hulumtimeve, mendimeve dhe intervenimeve antropologjike dhe perspektivave të shumëfishta për ta kuptuar të kaluarën dhe imagjinuar të ardhmen.

28 janar

Dr. Florian Jedrusiak – Paris Ouest Nanterre - La Défense University

Edicioni i III-të i seminarit të antropologjisë, në kuadër të Departamentit të Antropologjisë, filloi me 27 shkurt 2021, me një temë mjaft interesante. I ftuar ishte Dr. Florian Jedrusiak nga Université Paris Nanterre, i cili ligjëroi rreth temës “Ushqimi në antikitetin e vonë - rasti i Ulpianës antike”. Pra, kësaj radhe nuk u fol vetëm për data, luftëra apo objekte, mirëpo, qëllimi ishte të njihemi më shumë me përditshmërinë e banorëve të Ulpianës, konkretisht lidhur me aspektet e ushqimit. Dr. Jedrusiak si specialist i karpologjisë, fillim-

isht dha informacione bazike rreth kësaj disipline, e cila përmes analizimit të farave tenton të ndërtojë një ide rreth mënyrës së të ushqyerit në antikitet. Pas disa ekspeditave arkeologjike në lokalitetin e Ulpianës, ai prezantoi para nesh disa rezultate fillestare që vijnë nga ky lokalitet. Analizat u koncentruan në zonën e cloaca maxima në afërsi të bazilikës së fortifikuar paleokristiane. Nga ky kuadrat, dolën fara të drithërave të ndryshme si grurë, elb, mel, thekër etj; nga perimet u dalluan fasulja, bizelet dhe lentet. Analizat e farave dëshmojnë për

konsumimin e frutave të ndryshëm. Po ashtu, mes tjerash u dalluan farat e lajthisë, pjeshkës dhe rrushit, që datohen mes shekujve III-IV. Ndërsa, disa fara tjera të dëshmuara mes shekujve IV-VI janë ato të arrës, mjedrës dhe qershisë. Pyetjet ishin të shumta në mbarim të këtij prezantimi, ndërsa Dr. Jedrusiak tërhoqi vëmendjen se, rezultatet janë fillestare dhe të pamjaftueshme për të nxjerrë përfundime në këtë fazë. Prandaj, po punohet fuqishëm që në vitet e ardhshme të arrijmë të krijojmë një mendim më të detajuar rreth ushqimit në Ulpianën antike.

Human food at the end of Antiquity: the example of Ulpiana (Kosovo)

Use of Carpology (first steps)

by
Florian Jedrusiak
(UMR7041-Equipe GAMA-Archéobotani. ent.)




25 shkurt

Dr. Stefan Dorondel - Francisc I. Rainer Institute of Anthropology

Dr. Stefan Dorondel - Francisc I. Rainer Institute of Anthropology, mbajti prezantimin "Ishujt, lumenjtë dhe njerëzit: Qasje shumëllojëshe". Dorondel paraqiti skemën e hulumtimit ekipor të cilin po e realizon në ishujt lumor (fluvial) të Danubit në Rumanisë, si dhe pyetjet dhe disa nga propozimet fillestare të këtij hulumtimi. Ai na ftoi të konsiderojmë rëndësinë e këtyre ishujve për shkencat shoqërore, të cilat në përgjithësi ia kanë lënë këtë hapësirë shkencave natyrore. Argumentoi se, gjithnjë e më shumë e shohim nevojën e bisedimeve ndërdisiplinore, duke shpalosur tri perspektivat të cilat

i gjejmë në analizat ekzistuese: 1. Gjeomorfologjike - ku njerëzit nuk konsiderohen në analizë; 2. Gjeopolitike - ku kryesisht trajtohen konfliktet juridike dhe politike; 3. Qasjen shumëllojëshe - ku argumentohet se realitetet shoqërore formësohen edhe nga llojet (speciet) e tjera përveç njeriut (mikrobet, kafshët, bimët) dhe procese të ndryshme (p.sh. hidrodinamikat e lumenjve). Kjo ligjëratë trajtoi mënyrat se si lëvizja e ishujve Danubian është ndërlidhur me shtetet bregore (riparian) dhe komunitetet vendore në Rumani dhe Bullgari, gjate periudhës 1830-2020 dhe se si këto ndër-

lidhje bashkë-prodhojnë ngjarje politike, ekonomike dhe epizoike. Metodologjia e propozuar përmban analizë histoke (arkiva lokale dhe kombëtare), etnografi dhe vëzhgim-pjesëmarrje (etnografi shumë-vendore), analiza gjeografike, dhe analizë të medieve.



26 mars

Dr. Bleta Arifi - Albert-Ludwigs-University Freiburg

Me përgatitje nga filozofia gjer-mane, qeverisja ambientale dhe punë kërkimore në Institutin për Shkencat Sociale Ambientale dhe Gjeografi, Universiteti i Freiburg-ut, Dr. Bleta Arifi e pasuroi seminarin me qasjen e saj ndërdisiplinore kundrejt politikave energjetike dhe mobilizimit shoqëror. Ajo na njoftoi për hulumtimin e saj rreth projektit për termocentralin Kosova e Re, me titullin “Një shpalosje e racionaliteteve dhe praktikave qeverisëse në sektorin e energ-

jisë në Kosovë.” Bazuar në analizë diskursive dhe vëzhgim me pjesëmarrje, Arifi argumenton se, sistemet energjetike janë sisteme socio-teknike nëpërmjet të cilave zhvillohen dhe kundërshtohen subjektivitetet shoqërore dhe politike. Në rastin e TC Kosova e Re, me anë të valorizimit “të dy resurseve kosovare: rinisë dhe thëngjillit” pushteti qeverisës prodhon subjekte (prosumator; ambientalist; qytetar politik) dhe objekte (siguria energjetike; rrjetet energjetike; klima) të tranzicioneve energjetike,

të cilat janë thelbësisht rikonfigurime të marrëdhënieve shoqërore.

Prapavija e kumtesës



Protestë anti-nukleare

Source: Leo Horlacher, Archiv Soziale Bewegungen Freiburg. Original smiling sun logo: Anne Lund



Protestë kundër mihjes në Hambacher Forst

Source: Von Leun, CC BY-SA 4.0, <https://commons.wikimedia.org/w/index.php?curid=73052545>



Protestë kundër parqeve të erës

Sources: Windkraftfreier Soonwald e.V. <https://www.windkraftfreier-soonwald.de/wir-wir-sind/>; Logo: <https://tinyurl.com/y2cflm89>

- Qeverisja e tranzicioneve energjetike
- Rezistenca ndaj infrastrukturave energjetike pjese kyce e konflikteve rreth ketyre tranzicioneve

(Bulkeley & Strippel 2013, Cuppen 2018, Gailing 2016, Paul 2018, Smith 2012)

22 prill

Dr. José C. Carvajal López - University of Leicester

“Peizazhet e ujit, peizazhet e pushtetit: Politikat hidraulike në Butrint (Shqipëri) në mes të Venedikasve dhe Otomanëve” ishte titulli i prezantimit të punimit nga Dr. Carvajal López. Lokaliteti arkeologjik i Butrintit, në jugun e Shqipërisë, njihet për gërmadhat e periudhës klasike, mirëpo, ka edhe një histori interesante nga periudha e vonë moderne. Zotërimi i Butrintit, i cili njihet si “Syri i Korfuzit” në periudhën e venedikase, ishte kyç në mes të shek. XIV dhe XVIII për ta garantuar sigurinë e kolonisë së Korfuzit. Kjo qasje ishte vazhdimësi e marrëdhënieve ngushtë të përcaktuara në mes të Butrintit dhe Korfuzit që nga periudha Klasike. Marrja e Butrintit

nga Otomanët, veçanërisht nga Ali Pasha, në fund të shekullit XVIII, e ndryshoi orientimin e Butrintit, duke e ankoruar vendosmërisht me posedimet në brendi të Pashës, gjë që vazhdon deri në ditët e sotme. Carvajal López, na prezantoi analizë historike-arkeologjike mbi mënyrat se si politikat në mes të venedikasve, otomanëve dhe njerëzve të cilët jetonin në hapësirat e Butrintit u reflektuan në rrugët ujore të Butrintit. Mbyllja e lidhjes me Korfunë, ai argumenton, solli edhe ndryshime substanciale në ekonominë e asaj zone, ndryshime të cilat reflektohen në eksploatimin e burimeve dhe habitatit në Parkun Nacional të Butrintit.

20 May

Prof. Dr. Kelly Askew – Departmenti i Antropologjisë dhe Studimeve Afroamerikane & Afrikane, University of Michigan – Ann Arbor

Për katër vite me radhë ekipi ndërdisiplinor i projektit “Mirëqenia dhe energjia e ripërtëritshme në Tanzaninë rurale” po i hulumton me anë të metodave të shumëfishta transformimet e relacioneve në mes të shtetit, komuniteteve rurale dhe energjisë, si dhe projekteve ndërkombëtare, në 45 fshatra të Tanzanisë. Në ligjëratën e saj “Në errësirë: Politikat e energjisë në Tanzaninë postsocialiste,” Askew i trajtoi proceset makro-historike në Tanzani (kolonializmin, socializmin, dhe neo-liberalizmin) për ta kornizuar kontekstin e ndërhyrjeve të reja zhvillimore, me anë të pro-

jekteve të cilat synojnë ‘ndriçimin’ e hapësirave rurale. Dëshira për qasje në energjinë elektrike, trajtohet nga ajo si nga perspektiva e shtetit ashtu edhe e banorëve të fshatrave të cilat përfshihen në studim. Veçanërisht, hulumtimi synon ti kuptojë zbrazëtitrat socio-ekonomike nga qasja etnografike-antropologjike dhe tregojë se si proceset e industrializimit e anashkaluan zhvillimin agrar me pasoja të vazhdueshme në mirëqenien e qytetarëve.

Tanzania to build Stiegler's Gorge dam in a wildlife reserve and Unesco site



9 January 2020, by [Mike Mwanza](#)



President Magufuli is unmovable in going ahead with the Stiegler's Gorge dam despite conservationists' warnings of the damage it will cause the Selous Game Reserve's ecosystem and wildlife.

(IN PROGRESS)



27 Maj

Dr. Adrian Anastasin, Akademia e Studimeve Albanologjike

Në kuadër të seminarit të Antropologjisë, me datë 27.05.2021 departamenti organizoi ligjëratë me Prof. Dr Adrian Anastasin me temë “Arkeologjia nënujore në Shqipëri”. Për mbi një orë e gjysmë u diskutua rreth zhvillimit, sfidave dhe të ardhmes të kësaj disipline arkeologjike. Kuptuam rreth metodave të ndryshme që praktikohen për të arritur deri tek rezultatet. Mes tjerash, prof. Anastasi shpjegoi për lokalitetet nënujore në Shqipëri, për zonat e strehimit të anijeve, thellësimatësit, llojet dhe emërtimet e spirancave, shikueshmërinë e horizontit, përlllogaritjen e distancave etj. Po ashtu, u paraqiten me dhjetëra fotografi të gjetje-

ve të ndryshme nënujore, siç janë anije të ndryshme, spiranca, amfora etj. U përmenden gërmimet e realizuara në Liqenin e Ohrit, atë të Prespës, Gjirin e Durrësit, Gjirin e Vlorës etj. Në pjesën e fundit të seminarit, u ngritjen pyetje të shumta nga dëgjuesit, ku ndër të tjera u diskutua rreth ekspeditave të radhës dhe, mbi vështirësitë që arkeologët hasin gjatë zhytjeve nënujore. Vlen të përmendet fakti që, kjo temë zgjoi interesim të madh, ku morën pjesë rreth 50 dëgjues. Ndërsa, prof. Anastasi shfrytëzoi rastin t'u bënte ftesë studentëve të departamentit tonë që të bashkohen në ekspeditën e tij të radhës në liqenin e Ohrit.



Deri në fund të vitit kalendarik do të mbahen edhe prezantimet në vazhdim:

Prof. Dr. Andrea Pieroni - University of Gastronomic Sciences Pollenzo

Etnobotanika dhe trashëgimia e ushqimit në Ballkan: Folklor apo shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm?

Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi – Universiteti I Prishtinës

Ekologjia sakrale dhe etika ambientaliste

Prof. Asoc. Dr. Nebi Bardhoshi – Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë

Mbi antropologjinë e ujit: Natyra, kultura dhe 'shpirtat' e shtetit bashkëkohor

Prof. Ass. Dr. Nita Luci dhe Dr. Linda Gusia - Universiteti i Prishtinës


Hapësirat dhe vizionet e aktivizmit likuid: Transformimet e energjisë, solidaritetit dhe ambientit në Kosovë



“Dardania antike” (Muzeu Kombëtar i Kosovës, 2021, Prishtinë)

Autorë: Arben Hajdari & Milot Berisha

Muzeu i Kosovës botoi librin “Dardania antike”, një katalog/udhërrëfyes i ngjeshur narrativ mbi ekspozitën e përhershme në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Ky katalog është shkruar nga Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari nga Departamenti i Antropologjisë dhe Historisë dhe Milot Berisha, arkeolog në Institutin Arkeologjik të Kosovës. Katalogu analizon artefaktet e ekspozuara në ekspozitë, si në kontekst historik, ashtu edhe në atë kulturor dhe ofron një guidë mjaft të ngjeshur për ekspozitën “Dardania antike”, ku shqyrtohet një periudhë e gjatë, prej parahistorisë neolite deri në mesjetë, me fokus në periudhën dardane. Katalogu është përkthyer në gjuhën angleze, frënge dhe serbe.



“Kosova antropologjike” (IAKSA, 2020, Tiranë)

Redaktorë: Nebi Bardhoshi & Arsim Canolli

“Kosova antropologjike” është një përmbledhje esesh, që janë dhënë fillimisht si kumtesa në konferencën “Perspektiva studimore mbi Kosovën”, organizuar më 20 dhe 21 dhjetor 2019 në Tiranë, nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit/ASA dhe Departamenti i Antropologjisë/FF/UP. Nën kujdesin redaktues të Nebi Bardhoshit (IAKSA) dhe Arsim Canollit (DA), ky libër përmbledh një sërë esesh nga profesorët e Departamentit të Antropologjisë dhe studiuesit e tjerë pjesëmarrës në konferencë. Mes tjerash, kemi esetë e Arsim Canollit, Durim Abdullahut dhe Zanita Halimit nga Departamenti i Antropologjisë.

Po ashtu, librit i prin një hyrje nga redaktorët, që paraqet një hyrje të shkurtër të historisë së etnologjisë në Kosovë dhe mbi Kosovën. Libri ofron një pamje të gjendjes së studimeve antropologjike në Kosovë, ku preken tema si familja transnacionale, antropologjia e ligjit, studimet ekokulturore, dokumentimi i kujtesës së luftës, fotografia familjare, kultura e bukës, muzeut dhe festivaleve folklorike etj.



“Katalogu i andrrave” (CHWB, 2021, Prishtinë)
Autore: Lira Blakaj dhe Bjeshkë Guri

Ëndrrat janë temë pothuajse e pastudiuar fare në letrat etnologjike/antropologjike shqipe. Në vitin 2021, një studim specifik erdhi nga antropologët Lira Blakaj dhe Bjeshkë Guri, duke sjellë një freski në tematikën antropologjike shqiptare. Katalogu ofron një pamje të studimit mbi ëndrrat në antropologji dhe fusha të tjera të shkencave sociale, vjen si një konverzacion me teoritë mbi ëndrrat, hapë diskutimin për modelin tradicional të ëndrrave të shqiptarët dhe shtjellon këtë model në kontekst komparativ. Po ashtu, duke qenë një studim antropologjik, në analizë mishërohet evidenca empirike, e vjelë nga autorët.

Ky katalog sjellë një kallxor të kategorive e simbolikës së ëndrrave, të cilat janë identifikuar si traditë ëndërrimit dhe interpretimit, që, sipas autoreve, përbëjnë edhe një model specifik, që ato e kanë quajtur “model tradicional”. Libri ka ilustrime të shumta dhe është i botuar në gjuhën shqipe dhe angleze.



“Katalogu Arkeologjik i Mitrovicës” (KnKub Heritage, 2020, Mitrovicë)

Autorët: Lekë Shala dhe Kaltrina Igrishta

Dy studentë të arkeologjisë, Lekë Shala dhe Kaltrina Igrishta, botuan katalogun “Katalogu arkeologjik i Mitrovicës” (me parathënie nga prof. Michael Galaty). Katalogu përshkruan 184 artefakte të zonës së Mitrovicës, në gjuhën shqipe dhe angleze, shoqëruar me fotografitë përkatëse të secilit artefakt. Profesor Galaty thekson se “ajo çfarë Katalogu Arkeologjik i Mitrovicës në fund vërteton është se regjioni dhe qyteti i Mitrovicës është larg prej të qenit i izoluar, ky qytet ka qenë gjithmonë pjesë e rrjeteve tregtare dhe të bashkëveprimit shoqëror.” Artefaktet e dhëna në këtë katalog, të cilat janë pjesë e deposë së pasur të Muzeut të Mitrovicës, janë edhe një dëshmi e Kosovës arkeologjike të mbrumur në shtresa të ndryshme, në ato parahistorike, të Dardanisë antike, e deri te shtresat e vona.

Valon Shkodra

ZEJET TRADICIONALE TË QYTETIT TË PRISHTINËS

(Katalog)



“Zejet tradicionale të qytetit të Prishtinës (IAP, 2020, Prishtinë)

Autor: Valon Shkodra

Valon Shkodra, hulumtues në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ish-student i Departamentit të Antropologjisë, ka botuar katalogun me 113 fotografi të zejeve tradicionale të Prishtinës, duke theksuar rëndësinë historike e antropologjike të zejeve, si praktika të rrezikuara nga zhdukja. Ky katalog është dëshmi dhe ftesë për të vepruar në ruajtjen dhe promovimin e zejeve në Prishtinë, por edhe gjetiu në Kosovë, si trashëgimi kulturore shpirtërore dhe si praktika të shprehjes së artit e vlerave kulturore shpirtërore në Kosovë.

Katalogu është produkt i një pune etnografike të Shkodrës, i cili ka punuar me një mori zejtarësh dhe ka gërmuar arkivat e tyre personale për të gjetur evidenca specifike. Ai dëshmon se kanë ekzistuar mbi 30 lloje të zejeve në Prishtinë, e shumë pak sosh janë ende duke u praktikuar, gjë që dëshmon nevojën e ruajtjes së tyre si praktika të trashëgimisë kulturore shpirtërore.

INSTITUTI ALBANOLOGJIK

Dr. BASHKIM LAJÇI

ETNOLOGJI

RITE, DOKE E ZAKONE SHQIPTARE



Prishtinë, 2020

“Etnologji: Rite, doke e zakone shqiptare (IAP, 2020, Prishtinë)

Autor: Bashkim Lajçi

Etnologu i brezit të dytë të etnologjisë së Kosovës, Prof. Dr. Bashkim Lajçi, i cili ka punuar në Departamentin e Antropologjisë si mësimdhënës i angazhuar, ka botuar një përmbledhje me ese të botuara ndër vite në revista të ndryshme, mbi tema të ndryshme të vërtetimit etnografik, kryesisht të fushës së riteve e praktikave specifike kulturore, përfshirë veshjet, armët, besimet e besëtytnitë e ndryshme.

RETROSPEKTIVË

Në 20 vjetorin e themelimit të Departamentit të Antropologjisë (i quajtur Departamenti i Etnologjisë, më 2001) kemi realizuar dy intervista: njëra me iniciatoren e themelimit të Departamentit, Prof. Dr. Drita Halimi-Statovcin dhe tjetrën me Prof. Dr. Ukë Xhemaj, një ndër profesorët e parë të Departamentit. Intervistat janë realizuar në muajin gusht të vitit 2021, nga Zanita Halimi dhe Arsim Canolli. Po ashtu, Zanita ka realizuar edhe një intervistë me Nora Prekazin, një prej studenteve të gjeneratave të para të Departamentit.

Tre breza të hollë dhe një mbështjellak

(intervistë me prof. Dr. Drita Halimi-Statovcin)

*Z.H. Departamenti i Antropologjisë, i quajtur asokohe Departamenti i Etnologjisë, këtë vit ka 20 vjetorin e funksionimit. Si themeluese e Departamentit, a mund të na tregoni si filloi ky rrugëtim?


D.H-S. Familjet në të cilat lindë njeriu janë fat i secilit njeri dhe nga këtu fillon baza e formimit jetësor. Së pari, të them se unë pata fatin të rritesha e të formohem pranë babait tim-etnolog i parë shqiptar në Kosovë, Prof. Kadri Halimi. Kjo rrethanë jetësore ndikoi fuqishëm që, me një natyrshmëri të pahetueshme të më lindë dhe të më rritej interesimi për shkencën e etnologjisë. Më ndodhi që në moshën time 14-15 vjeçare ta përjetoj terrenin tim të parë, të them si vizitore, me rastin kur babai më mori në hulumtime në krahinën etnografike të Rugovës. Vizitë kjo, që më ka lënë mbresa të pashlyeshme, e që me ëndje e kujtoj edhe sot. Gjithashtu, më kujtohet dita kur babai solli nga terreni tre breza të hollë, përafërsisht 2 cm. dhe një mbështjellak, ku mbisundonte ngjyra e kuqe, të gjitha të veshjes së grave. Nana ime brezat i adaptoi për mua si rrip për fustana, dhe këta unë i mbajta me shumë dashuri me uniformen e Gjimnazit gjatë tërë katër viteve të shkollimit të mesëm. Ende i ruaj këta breza: njëri me motive antropomorfë, tjetri me shqiponje dykrenëshe, të stilizuar dhe me dru jete dhe i treti me figura gjeometrike. Këto i ruaj si kujtim dhe si artefakte me një biografi si të njerëzve, për botën time sot, të komoditizuara e të ngritura deri në vlerë të shenjtë. Këto ngjarje e këto elemente, fare pahetueshëm dhe si një lajtmotiv, gjithnjë ma ushqenin dashurinë për etnologjinë.

Natyrisht se ndjenja për etnologjinë, ndryshe antropologjinë kulturore, u konsolidua disi më tepër në moshën pas kryerjes së shkollës së mesme-gjimnazit.

Pastaj punova në Institutin Albanologjik, ku falë përvojës së përfituar, si dhe aktiviteteve shkencore që zhvilloheshin aty, ndodhi të forcohej ndjenja për angazhimin tim që të hapet drejtim studimor etnologji-antropologji kulturore në Kosovën tonë. Në Prishtinë kishte një ndërgjegjësim intelektual për trashëgiminë kulturore dhe për njohjen e identitetit të qartë kulturor dhe etnik, prandaj ndodhi që në demonstratat gjithëpopullore shqiptare të vitit 1968 publikisht e zëshëm, ndër të tjera, të kërkohej edhe studime të profilit të etnologut. Më vonë, në vitin 1980 kishte edhe kërkesa institucionale verbale brenda Fakultetit Filozofik për studime etnologjike, ndonëse nuk kam arritur të gjej ndonjë dokument të shkruar e as të deponuar tek organet kompetente në Arkivin administrativ të këtij Fakulteti. Në vitin 1994 Departamenti i Historisë në Fakultetin Filozofik, për të parën herë në historikun e Universitetit të Prishtinës, në Plan-programet e veta mësimore vendosi lëndën me emërtimin Etnologji, ndërsa unë u zgjodha mësimdhënëse për këtë lëndë. Nga këtu, si dhe nga dashuria dhe respekti për babain tim etnolog, i cili vazhdimisht theksonte se pa studime të fushës së etnologjisë në vendin tonë, nuk mund të kemi kuadro të mjaftueshme e shumë të nevojshme të profilit të etnologut, si dhe për arsye të realitetit të asaj kohe, më ndodhi që etnologjia të më bëhej dashuri, por edhe motivim i vazhdueshëm deri në obligim qenësor të jetës sime.

Në instancat përkatëse të Fakultetit Filozofik, dhe të Universitetit të Prishtinës shumë herë e shtrova çështjen e themelimit të Departamentit të Etnologjisë, por në fillim vetëm verbalisht. Mbretëronte një skepticizëm se nuk kemi kuadro të mjaftueshme për këtë profil studimor, që thënë të drejtën ishte realitet.

Megjithatë, unë këmbëngulja për drejtim të pavarur të etnologjisë dhe antropologjisë kulturore. Pas çlirimit të Kosovës, në vazhden e përpjekjeve për reforma avancuese në Universitetin tonë, saktësisht në vitin 2001, bisedohej e diskutohej se në Fakultetin Filozofik do hapen tri drejtime të reja, përkatësisht Drejtimi i shkencave politike, Drejtimi i psikologjisë dhe Drejtimi i shkencave sociale. Ishte rast i mirë të shtohet edhe Drejtimi i studimeve antropologjike. Prandaj, unë përgatita një propozim dhe arsyetim me shkrim të Plan-programit për studime në fushën me emërtimin Etnologji dhe Antropologji kulturore e sociale, përfshirë shkallën BA e deri në Master dhe PhD. E deponova në Dekanatin e Fakultetit Filozofik për mbledhjen e radhës të Këshillit shkencor, dhe e regjistrova si dok. nr. 549, dt. 06.06.2001 në Administratën-Sekretarinë e Fakultetit Filozofik. Po të njëjtin dokument e dorëzoja në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, dhe në Zyrën për çështje të Studimeve shoqërore, që atëbotë vepronte nën administrimin e UNMIK-ut, në ndërtesën e Kuvendit të sotëm të Republikës së Kosovës.



Pjesë e dok. nismëtar për Departamentin Etnologji-Antropologji kulturore dt.08.06.2001
Dok. 20. 06. 2001- Vendimi i UP për Grupin punues

Pas këtij hapi, ndodhi që Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e vet dt. 14.06.2001 e aprovon këtë propozim dhe nxjerrë Vendimin për emërimin e Grupit punues për hartimin e Elaboratit për hapjen

e Degës së Etnologjisë (dok. nr. 210, dt. 20.06.2001). Më e rëndësishmja dhe më e bukura e gjithë kësaj ecejakeje është se, ndodhi hapja e Degës së Etnologjisë, bashkë me tri Drejtime të tjera (shih Konkursin në Kohën ditore, dt. 17.09.2001). Këtu shihet Regjistri i kandidatëve që kanë kaluar provimin pranues, përkatësisht janë pranuar 32 studentë në vitin e parë të studimeve në Degën Etnologji. Për mua ishte kjo ngjarje e shënueshme dhe gëzim tepër i madh, ishte satisfaksion personal, por edhe familjar. Si për kuriozitet, ndodhi që në këtë vit, pra në vitin 2001 të pranohen saktësisht 16 femra dhe 16 meshkuj, koincidencë interesante rastësore dhe e pa pritur! Përfundimi fatlum: në tetor të vitit 2001 filloi punën për të parën herë në Universitetin e Prishtinës - në Fakultetin Filozofik - Departamenti i Etnologjisë. Pra, nuk u pranua pjesa Antropologji, që realisht nuk më brengosi shumë, sepse njësoj lënda e duhur përfshihet edhe në emërtimin etnologji, ndërsa programet zhvillohen dhe evoluojnë. Pikërisht në kohen e sotme, ky Departament vazhdon punën me emërtimin Antropologji.

*Z.H. Për të hapur një drejtim si Etnologjia, të parin në vendet shqipfolëse, nuk ka qenë e lehtë fare, a mund të na tregoni sfidat të cilat i keni hasur?

D.H-S. Plotësisht e vërtetë. Ishte e habitshme se nuk kishte drejtim të veçantë studimor as në Tiranë, por atje etnologjia si lëndë e vetme ligjërohej me kohë brenda drejtimit të Historisë. Ndërsa këtu në Kosovë, falë largpamësisë së kolegëve të Degës së Historisë në Fakultetin Filozofik, kjo u arrit vetëm në vitin 1994. Përkrahja për të themeluar një drejtim të veçantë studimor për fushën etnologjike-antropologjike kulturore, si mbështetje morale e kolegjale, vinte nga kolegët e Institutit Albanologjik, ku kisha marrëdhënie të rregullt pune deri në themelimin e Drejtimit të Etnologjisë në Fakultetin Filozofik, përkatësisht deri në tetor të vitit 2001. Përkrahje kishte edhe nga kolegët e Degës së Historisë të Fakultetit Filozofik, si dhe nga kolegët e Institutit të kulturës popullore në Tiranë. Sfidat më të mëdha ishin të sigurohet kuadri mësimdhënës me kushte që plotësonin kriteret akademike. Për të funksionuar një Departament i pavarur brenda Universitetit të Prishtinës, atëbotë ishte e përcaktuar me Ligj, që Departamenti të ketë në marrëdhënie të rregullt pune së paku tre doktorë shkence, ndërsa në rastin e Departamentit të Etnologjisë, për fillim, unë isha e vetmja me këtë titull shkencor nga stafi me marrëdhënie të rregullt

pune. Vërtetë sfidë vështirë e kalueshme. Kjo gjendje mbulohej disi me stafin e angazhuar nga jashtë Universitetit, për të mbajtur mësim në Departamentin tonë. Në radhë të parë ishin kolegët nga Instituti Albanologjik, pastaj kolegët e Departamentit të Historisë, kolegët nga Instituti i Tiranës, nga Universiteti i Vjenës dhe nga Universiteti i Lubjanës. Përveç këtij stafi, në Departamentin tonë organizonim dhe ftonim edhe profesorë vizitor, nga UP dhe nga qendrat europiane, në mënyrë që mësimdhënia të jetë e nivelit sa më të lartë dhe i krahasueshëm me Europën. Kjo ishte gjendja për nivelin Bachelor dhe njësoj për nivelin Master, por mjerisht niveli Master, pikërisht për mungesë të kuadrit me tituj përkatës shkencor që kërkoheshin me ligj, u lejua vetëm për një gjeneratë.

*Z.H. A mund të na përshkruani gjeneratat, interesimin, punën në terren e të tjera?

D.H-S. Secila gjeneratë kishte sharmin e vetë. Studentët ishin të përkushtuar dhe të zellshëm, shumë të interesuar për mësimnxënie sa më të madhe e me spektër sa më të gjerë. Gjatë ligjërimit bënë lloj-lloj pyetjesh, madje edhe jashtë fushës antropologjike. Unë i doja dhe vazhdoj t'i dua studentët me shumë sinjeritet, angazhohesha me ta për çdo kërkesë të tyre rreth mësimi. Dëshiroj ta theksoj një fakt, që më ka lënë mbresa të pashlyeshme. Ende pa filluar mësimnxënia me ligjërata të rregullta, në testet pranuese për studimet Etnologji të afatit shtator 2001, kërkohesh edhe një ese e shkruar. Mua personalisht, por edhe Komisionin për vlerësimin e provimeve pranuese, këto ese vërtetë na mrekulluan dhe na bënë të kërkojmë rritjen e numrit për pranimin e studentëve.



Lajmërimi dhe ftesa për ekspozitë (maj 2003).

Nuk dua të përsëris këto realitete, por e prekur dhe e emocionuar pozitivisht nga shkrimet shumë të suksesshme të kandidatëve për t'u bërë studentë, madje kishim një ese të shkruar në anglishte, me kujtohet se fill pas mbarimit të provimeve pranuese, saktësisht më 13 tetor 2001, në gazetën Koha për kulturë, pata botuar një shkrim të shkurtër me titull Ese mbi esetë! Dëshiroj të besoj se këto ese të studentëve ruhen në dokumentacionin e ndonjë fondi arkivor të Fakultetit Filozofik. Ato kohë në Kosovë ende na mbante gjendja e ndjenja e Luftës së fundit 1998-1999, e ky realitet reflektonte fuqishëm në esetë e studentëve-kandidatë për regjistrim në studime të rregullta në Etnologji.

Për studentët por edhe për mua personalisht, puna në terren ishte përjetim dhe mësim më vite. Studentët ishin shumë kolegial ndërmjet vete, shumë korrekt me subjektet në terren dhe shumë eksplorues në veprime. Madje, ka ndodhur që ta fitonin simpatinë e subjekteve të terrenit dhe disa herë të fitojnë dhuratë ndonjë artefakt-eksponat, për një galeri të mundshme për Degën e Etnologjisë. Më duket se këto eksponate ende ruhen diku në zyrat e Departamentit të Antropologjisë, si fjala vjen: ndonjë petk kostumor, ndonjë shtroje e vogël, ndonjë marhamë krahu, apo ndonjë shpatë veku, e të ngjashme. Entuziazmi i asaj kohe ishte i papërshkrueshëm. Subjektet bashkëbiseduese habiteshin dhe gëzoheshin njëkohësisht, që kemi arritur të ju shkojmë për hulumtime me grup studentësh etnologë.

*Z.H. Ju keni iniciuar edhe bashkëpunime ndërkombëtare me Universitete jashtë UP-së, ku shumë studentë kanë përfituar nga ky bashkëpunim. A mund të na tregoni më tepër, si erdhi deri tek ky bashkëpunim?

D.H-S. Fillimi i punës së Departamentit ishte vërtetë i vështirë, por, përkundër vështirësive kishte plot suksese. Po e theksoj si të veçantë ndihmën e madhe në mësimdhënie të kolegëve etnologë nga Shqipëria, por edhe nga kolegët brenda Kosovës. Gjithnjë punohej mbi bazën e rregullave akademike universitare, mbi bazën e ligjeve të UP-së, ndërsa nga bashkëpunimi kryesisht përfitonte Departamenti jonë. Profesorët nga jashtë vendit, të cilët i ftonim për mësimdhënie, thuaja të gjithë, entuziazmoheshin me interesimin dhe me punën rezultative të studentëve

tanë, por edhe pëlqenin fort bisedat kolegjiale të stafit të Departamentit tonë. Me dashamirësi kolegjiale e njerëzore për Departamentin tonë, kishite raste që të na ndihmonin edhe jashtë aspekteve thjesht mësimdhënëse. Prof. Koestlin nga Universiteti i Vjenës, bëri që Bibliotekës së Departamentit të Etnologjisë, nga shteti i Austrisë t'i falet një kontigjent i tërë librash antropologjike, që ende ruhet në kabinetet e Departamentit të Antropologjisë. Gjithashtu, ky profesor i Vjenës, duke na informuar për konkurse të rregullta të Austrisë, u angazhua që studentët tanë të studimeve Master, të fitojnë bursa nga 5 muaj qëndrim studimor në Austri, saktësisht në Departamentin e Etnologjisë Europiane të Universitetit të Vjenës, nga dy kandidatë brenda vitit, duke filluar nga viti 2006 deri më 2011. Shumica e këtyre studentëve e shfrytëzuan këtë kohë pikërisht për hulumtime rreth temave të tyre të Masterit, por edhe më tepër. Një bashkëpunim i ngjashëm ishte edhe këtu në Universitetin e Prishtinës, kur dy-tre studentët tanë përfituan bursa prej asociacionit, të quajtur atëbotë: Qendra Francois Furet & Kolegji Gani Bobi (ndryshe-Qendra për studime humanistike "Gani Bobi"). Marrë parasysh të gjitha këto që i shtrova, them se ishte ky sukses i madh për një Departament të vogël të Etnologjisë!

*Z.H. Keni realizuar shumë projekte me studentë, cilin prej tyre do ta veçonit dhe pse?

D.H-S. Gjatë ligjërimit në Departamentin e Etnologjisë, më vonë Antropologjisë kulturore, angazhohesha edhe përtej punës thjesht pedagogjike e të ligjërimit, qoftë ky ligjërime eks-katedra, ligjërime interaktiv, pastaj ligjërime me skica e shembuj në tabelë, me foto filma e sllajde, me ese të shkurtra nga studentët e mënyra të tjera. Studentët i doja shumë dhe i kam pikë të dobët, prandaj bashkë me ta angazhohesha për punë hulumtuese shkencore në terren, për ekskursione vizituese dhe mësimore, për realizimin e ekspozitave etnografike, për organizimin e performancave mësimore e të ngjashme. Ekspozitën e parë etnografike, për të cilën me mirëkuptim shfrytëzuam lokalet në Institutin Aalbanologjik të Prishtinës, bashkë stafi dhe studentët e Etnologjisë e realizuam në maj të vitit 2003 (shih foto e lajmërimit dhe e ftesës). Kjo ekspozitë zgjoi interesim të madh, madje jo vetëm për etnologët. Më tutje, ekskursionin e parë jashtë Kosovës e realizuam në Republikën e Shqipërisë, në qershor të vitit 2003, me mbështetjen

financiare të Qendrës për Edukim të Kosovës (KEC) dhe të disa individëve dashamirës të Departamentit. Atëbotë kishim studentët e dy gjeneratave të vitit akademik 2001/2002 dhe të vitit 2002/2003. E bukura e së bukurës së këtij ekskursioni ishte bashkëpunimi, respektivisht ligjëratat e Akademikes së parë shqiptare-etnologes Prof. Andromaqi Gjergji për studentët e Departamentit tonë të Etnologjisë. Akademikja Gjergji, përkundër faktit se ishte e pensionuar dhe lodhjes që kishte, e tejkaloi këtë gjendje dhe për dashurinë dhe simpatinë ndaj studentëve tanë pranoi të takohet me ne dhe të na jep një ligjëratë shumë domethënëse. Ishim të gëzuar të dy palët dhe ky takim nuk mund të harrohet.



Një grup studentësh të Etnologjisë, maj 2010

Me këto numërime në mesin e këtyre angazhimeve do e veçoja edhe një botim timin të vogël me vëllim, por tejet simpatik e domethënës, me titull Libretto Etnologjik-Veshja Ligjëron, të vitit 2010. Këtë e pata shkruar enkas për studentët, me një përmbledhje edhe në anglishte. Ky botim paraqet për të parën herë akademizimin e mësimit performativ të lëndës Veshjet Shqiptare, ndërsa studentet e studentët ishin vërtetë të mrekullueshëm. Nuk recitonin, por me një qëndrim rinor thjeshtë e mirë, ashtu siç e përgatitëm bashkë performancën, shpjegonin fare natyrshëm kostumin që e mbanin në trup, ose detajet kostumore të veshjeve të ndryshme (shih foto detaj marrë nga emisioni RTK, dt. 29.05.2010). Kishte aty veshje popullore, veshje zyrtare, veshje uniformash moderne, veshje sportive etj. E theksoj me këtë rast edhe mirëkuptimin bashkëpunues të Muzeut Etnologjik të Kosovës, që atë kohë na mundësoi të performojmë në oborrin e vetë, me pamje vërtetë etnografike. Kjo ngjarje madje tërhoqi vëmendjen edhe të shtëpive televizive,

dhe sot mund të shikohen me ëndje dhe interesim këto incizime të asaj kohe.

*Z.H. Departamenti i Antropologjisë sot është departament shumë i suksesshëm, me staf të ri e të përkushtuar, si e vlerësoni zhvillimin e Departamentit dhe të etnologjisë e antropologjisë kulturore në përgjithësi?

D.H-S. Rritën e Departamentit të Etnologjisë, sot Antropologjisë, e pres gjithnjë me gëzim, me dashuri e dashamirësi të sinqertë dhe në një mënyrë e shoh edhe vetën pjesë të këtij Departamenti. Më mbushin plot pozitivizëm sukseset e Departamentit dhe rrita e studimeve në fushën e gjerë antropologjike. Tani kanë arritur kuadro të reja të profilit përkatës antropologjik, madje deri në nivelet më të larta të titullit doktorë shkence. Departamenti është i plotësuar dhe besoj se do bëhet gjithnjë e më mirë. Të kënaq fakti se në mesin e këtyre pedagogëve e shkencëtarëve të rinj, ka edhe kandidatë-dikur studentë të Etnologjisë të Universitetit të Prishtinës. Kësaj i thonë arritje, rezultat pozitiv, i thonë mrekulli. Të mbush plot energji bashkëpunimi i gjerë brenda e jashtë Universitetit tonë, veçanërisht gama e gjerë e temave dhe e studimeve që i jep gjenerata e sotme e profilit të antropologut kulturorë. E përgëzoj këtë sukses të arrirë.

*Z.H. Porosia e juaj në këtë 20 vjetor do të jetë shumë e vlefshme, cila është kjo?

D.H-S. Nuk është aq e lehtë porosia, por po jap disa pikëpamje të mia. Të hulumtosh në terren pranë e pranë njeriut, kudo qoftë ky, është privilegj i veçantë; të kërkosht krahasimin dhe mbështetjen teorike në literaturën dhe teorinë antropologjike botërore dhe të asaj që do ta gjesht në terrenet e kulturës vetanake, është një ndjenjë përgjegjësie dhe saktësie profesionale shkencore, që të mbushë me satisfaksion të arritjes shkencore, por edhe të përgjegjësisë vetanake; të intervistosh njerëzit kërkon afri të çiltër, por edhe mjeshtëri e maturi të drejtpërdrejtë kudo e me këdo që bisedon; t'i vlerësosh drejtë arritjet e gjeneratave të etnologëve të hershëm e të thesarit që kanë lënë ata, është jo vetëm aftësi e zotësi, por edhe përgjegjësi e ndërgjegjësimi i madh. Të gjitha këto besoj se i duhen studentit tonë, gjeneratave tona të reja. Etnologjia dhe etnologët-antropologët kulturorë kanë për detyrë t'i kuptojnë proceset refleksive, t'i gjurmojnë dhe t'i kuptojnë lëvizjet e ndryshme të kohës, t'i përcjellin ndryshimet dhe glo-

balizimet bashkëkohore dhe në këtë kontekst ta gjejnë vetën si pjesë të studimeve të botës antropologjike shoqërore bashkëkohore. Më bëhet se do të pajtohem që studimin, profesionin dhe punën që e zgjedhim për jetë, duhet ta dashurojmë me sinqeritet. Të punojmë me përkushtim, me konsekuencë dhe me besim në vetën, të mundohemi t'i kuptojmë në esencë dukuritë shoqërore e jetësore dhe lidhshmërinë e tyre, asnjëherë të mos lejojmë qasje mekanike e pa kuptim. Ka raste kur duhet të jemi shumë kërkuar edhe ndaj vetvetes. Kurrë nuk duhet të na mungojë motivimi për punë, sepse po e kërkojmë, patjetër se do e gjesht. Studentët dhe studiuesit e pedagogët tanë, të fushës së gjerë antropologjike, sot mund të punojnë pa drojë e kërkesave të Agjensionit të akreditimit dhe pa trembe nga mbyllja e përkohshme e Departamentit të Antropologjisë, sepse tani, falë Departamentit të këtij profili në Universitetin tonë, kemi mjaft kuadro përkatëse, madje edhe premtuese, që do na vijnë gjithnjë e më me perspektivë.

Zbulimi i votrave do nxjerr zjarr

(intervistë me Prof. Dr. Ukë Xhemaj)

*A.C. I nderuar profesor, këtë vit shënohet 20 vjetori i themelimit dhe hapjes së Departamentit të Antropologjisë. Ju ishit ndër profesorët e parë që iu bashkuat iniciativës së prof. Drita Halimi-Statovcit dhe filluat të ligjëroni në Departament. Na trego më shumë për fillimin?

U.Xh. Hapja e Departamentit të Etnologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, për kohën, ishte një ngjarje aq gjatë e pritur, e inicuar dhe e ndaluar, sa që na dukej si ëndërr. Universiteti i Prishtinës, por edhe niveli i arsimit parauniversitar në Kosovë, e për fat të keq edhe në Shqipëri, ishin hapësira shoqërore e institucionale, jo vetëm në Evropën Jug-lindore, por shumë më gjerë, ku nuk ju lejohej hapja e fushave për studimin e trashëgimisë kulturore. Duhet theksuar se me sa mund e përpjekje të parreshtura shumëvjeçare të Akad. Mark Krasniqit dhe personelit të Institutit Albanologjik të Prishtinës e me mbështetje të intelektualve shqiptarë në institucione kulturore, arsimore, por edhe politike të Kosovës, u arrit hapja e Sektorit të Etnologjisë, në kuadër Degës së Folklorit në Institutin Albanologjik, në vitin 1974, si paraprijëse e mbarë për hapjen e Departamentit të Etnologjisë në FF të UP në vitin 2001. Pa mëdyshje se këtu merita ka rektori i atëhershëm Dr. Prof. Ejup Statovci dhe mbështetësit e Departamentit të Historisë, por edhe të departamenteve të tjera, pa përmendur emra të pëveçëm, ndonëse do u hymë në hak.

Si çdo fillim, edhe ky kishte vështirësitë e veta. Duhej kaluar faza e foshnjërisë. Megjithatë, mendoj se ishte më e shkurtër se sa menduam. Kjo falë gatishmërisë së kolegëve nga fusha përkatëse dhe simotra, që qenë të gatshëm për ligjërime. Në mesin e tyre pati që bënë punë edhe pa kompenzim material, dhe atë, për shumë vite. Dua me këte rast të falënderoj të gjithë e posaqërisht Prof. Dr. Rexhep Munishin, i cili për shumë vite ligjëroi etnomuzikologjinë me etnokoreografi, pa asnjë kompenzim. Si ky kontribut me ligjërata për shumë vite dha dhe Prof. Dr. Konrad Kestlin, nga Universiteti i Vjenës, i cili disa herë pasuroi bibliotekën e këtij Departamenti me botime të fushës së antropologjisë, ndihmesë kjo e veçantë për



një departament në vitet e para të punës.

Ishin ato vite entuziazmi për punë dhe synime të vënies së bazamentit të një disipline të munguar në Universitetin e Prishtinës. Përveç punës kabinetike duhej bërë edhe puna në terren. Për realizim të terrenit duheshin mjete. Ato mungonin! Me shumë sakrifica mbi bazë donatorësh realizonim ekspedita si në Kosovë ashtu dhe në Shqipëri, për çka u jemi mirënjohës dhe shumë falenderues gjithë donatorëve. Si do që të jetë, mendoj se sukseshëm e kemi përmbyllë këte etapë të jetës e punës në këte Departament, i cili po lëshon shtat dita-ditës dhe është në rrugë të mbarë me perspektivë të ndritur, çka me gëzon pamasë.

*A.C. Kadri Halimi dhe Mark Krasniqi janë të parët që nisën punën etnologjike institucionale në Kosovë, themelues të etnologjisë shqiptare në Kosovë. Si i mbani mend ata?

U.Xh. Vërtetë, punën institucionale në këtë fushë të parët në Kosovë e filluan Prof. Kadri Halimi dhe Akad. Mark Krasniqi, personalitete këto që lanë gjurmë me peshë në fushën e shkencës, kulturës, letërsisë, arsimit, po edhe në jetën politike. Ishin kuadër i mirëformuar profesionalisht; të dalë nga gjiri i popullit me modesti të kultivuar nga edukata familjare e jetës me traditë; ditën të peshojnë vlerat; njihnin mirë rrethanat dhe historinë e filozofinë e popullit që i përkisnin, po dhe të tjerëve përreth, ashtu që vepruan e krijuan për lakmi duke lënë një shembull për të lakmuar të gjallët dhe për t' u mburrë vendi që i pati. Vertikal dhe të qëndrueshëm, të pathyeshëm deri në fund të jetës. Nder i madh për mua që i pata profesorë e bashkëpunëtorë, për shumë vite të jetës sime.

*A.C. Më keni treguar shpesh për ekspeditat hulumtuese në terren, kur keni qenë në Insitutin Albanologjik. Si i kujtoni ato?

U.Xh. Vitet e punës në IAP e posaçërisht ato të punës në terren, për të cilat po më pyesni, i kujtoj me nostalgji, ndjesi të veçantë shpirtërore dhe rikthehem shumë shpesh me mbamendjen time, në formë meditimi, duke kujtuar gjithë atë ecejake pune, nëpër gjithë ato vende e copëza të trojeve shqiptare me kolegët e pandarë të institucionit ku punonim. Po aq e ndjeshme më vjen kujtesa me gjithë ato subjekte nga terreni, të cilëve u jemi pafundësisht mirënjohës, që na mirëpritën zemërgjerë në konak, na ushqyen e mbi të gjitha na mundësuan të vjelim thesar nga trashëgimia kulturore, vlerë e papërsëritshme dhe e domosdoshme për studim, ruajtje dhe identifikim.

Ekspeditat në vitet e 80-ta në IAP, organizoheshin dy herë në vit, në pranverë dhe vjeshtë, nga një muaj. Pastaj u shkurtuan në dy herë nga 15 ditë. Por, krahas tyre kishte edhe ekspedita individuale gjatë vitit, varësisht nga interesi individual. Ishin vite kur ngulmohej me të madhe që të vilej lënda burimore e trashëgimisë në gjithë fushat e kulturës shpirtërore, artistike e materiale. Kishim peripeti për realizimin e tyre, ngase nuk kishim mjete transporti. Më kujtohet tani, se njëri nga të parët, s'po i përmend emrin, ato vite mburrej se IAP është i vetmi institucion në Jugosllavi që nuk ka makinë fare, as për punëtorë as për drejtor. Si në kohën e Gjeçovit. Por kjo, hiq mundimet e eksploruesve, që anëmbanë trojeve në mot pa mot duhesh kaluar në këmbë, të lagur e të "kallur" nga vapa, pati përparësitë e veta, sepse kalum nëpër shumë shtigje të vendit: në Rrafsh, Rranzë, Vërri e Malësi duke qenë përherë në kontakt pune në mjedise familjare, lagje e fshatra,

për një muaj rresht.

Mund të ju them se në kohën kur bëheshin këto ekspedita jeta në Kosovë akoma kishte familjen tradicionale. Mirëqenja e saj ekonomike ngrihej mbi bazë të punës në bujqësi dhe blegtori. Ishte kryesisht e tipit të mbyllur. Andaj, ai brez ishte krijues i vlerave të trashëguara, në shumë fusha të kulturës materiale, shpirtërore e artistike. Mbi të gjitha ishin pasardhës të drejtpërdrejtë të brezit tipik burimor të taditës, ashtu që lënda e vjelur asokohe vinte nga krijuesit, kryesisht, e shumë më pak nga interpretues.

Puna nëpër oda, e në grup (punonjësisht-vjelës), krijonte vështirësi, por kishte edhe të mirat e veta. Së pari, ambienti ishte i mbushur me më shumë subjekte të një lëmieje të aktivitetit – ku hapej debati, shtrihej tema, përzgjedhej rrëfyeti. Meqë puna bëhej nga shumë fusha të trashëgimisë, ofrohej mundësia për debate e informacione nga fusha e folklorit, historisë, ekonomisë bujqësore e blegtorale, riteve e zakoneve familjare e shoqërore, miteve e mitologjisë, veshjeve e arkitekturës, e kështu më radhë.

Kur kujton rreth 40 vite punë, ku një pjesë e madhe qe kaluar në terren, të duket vetja i stërmoshuar. Por, kur mediton për të kaluarën nëpër gjithë këto vende dhe entuziazmin e atëhershëm, që trupit nuk i përcillte lodhje, por vetëm freski, të rrenë mendja se je akoma i ri.

Dua të kujtoj më këte rast një pohim të prof. Anton Çettës. Ishte vjeshtë e vitit 1976. Kishim një ekspeditë kolektive në Rugovë - në t'banana të fshatit Bogë. Në familjen Dembogaj. Punuam tërë ditën. Para se të binim në gjumë, deri sa e bënë gati shtrojën në t'banë, ne me të zotin e familjes dolëm jashtë. Ishte një natë vjeshte e freskët si në bjeshkë. Prof. Antoni kishte drejtuar shikimin kah kupa qiellore dhe po sodiste pa ndërprerje. Për një çast befi: "More burra, dua të ju them diçka, unë po me vdekë e me shkua pa e ditë se qielli paska kaq shumë yje. Kurrë në jetën time s'paskam parë kaq shumë yje!". "Këtu jemi më afër Zotit, për qata ka kaq shumë yje", ia ktheu i zoti i shtëpisë.

*A.C. Gjatë punës suaj në Departament, keni realizuar shumë ekspedita me studentë. A është puna në terren e domosdoshme edhe për studentët e Bashelorit?

Meqë Departamenti i Etnologjisë te ne fillonte punën rishtas, plan-programin e punës për studentë e kishim programuar të tillë që nga rreth 30 lëndë mësimore, 6 prej tyre i dedikoheshin kulturës dhe trashëgimisë shqiptare, ku secila nga to kishte 1, 2 ose 3 orë ushtrime, plus punën

në terren, që ishte obligative. Etnologjia s'mund të bëhet vetëm me punë kabinetike e teorike. Lënda, brumi i saj, gjendet në mjedise kulturore, të banuara apo të zhbanuara. Ato që bëjnë jetë aktive dhe ato që flenë nën dhe. Në natyrë: te një cukal, brijë mali ku qëndron një lis kulti; te mrize e gurra ku qëndojnë orët e zanat; te lugjet e shpellat me shtojzovallet e naletët; te mullinjtë; te vala e detit prej nga del floçka e bardhë; te shpella ku jeton divi-insan me një sy në ball; anekënd trojeve shekullore të mbuluara me ferrishte e barë, po dhe me lisa e pyje shekullore, do gjeni votrat ku "ruajnë prushin e mbuluar me hi, duke pritur agimin për t'u shpaluar dhe bërë flakë sërish".

Zbulimi i votrave do nxjerr zjarr, zjarri është jetë e flaka e tij dikënd e ngrohë e dikënd e djeg në këto troje. Buka pa brumë nuk gatuhet. Brumi është tek gurra popullore, në terren. Studentët, gjeneratat e ardhmërisë duhet ta kenë të domosdoshme terrenin dhe dorë të djathtë për të ngritë çështje, debatuar e krahasuar deri në studim të mirëfilltë teorik. Përvoja jonë na ka mësuar se puna e terrenit, me studentë e për studentë, është e domosdoshme. Për këtë me secilën gjeneratë kemi realizuar ekspedita 1, 2 e deri 14 ditore, në Kosovë dhe Shqipëri. Nga lënda e vjelur në terren përveç eksperincës që arrinin studentët, obligoheshin me punë seminarike e që temat e trajtimit, kryesisht, jepeshin nga puna e terrenit.

A.C. Si e shihni antropologjinë kulturore sot në Kosovë?

U.Xh. Antropologjinë sot në Kosovë e shoh fushë tashmë të konsoliduar dhe me orientim të drejtë dhe me perspektivë. Kuadri i tanishëm në këtë Departament është i profilizuar për këtë fushë, i moshës më të mirë krijuese dhe i angazhuar përveç procesit mësimor edhe në atë kërkimor-shkencor, në plotë ndërmarrje hulumtuese e studimore e në bashkëveprim me studentë të dalluar, konsideroj se janë duke përdorur metodë të drejtë e duke dhënë kontribut shumëfish të dobishëm. Kjo rrugë i hapë Departamentit një perspektivë kadrovike mësimore, por dhe shkencore.

Kuadri i tanishëm i kësaj fushe, në bashkëpunim me kuadra këtu në Kosovë dhe Shqipëri e më gjerë, ka ardhë koha, për të mos thënë e stërvonuar, që të fillojë t'i trajtojë temat tabu, siç është përballja me realitetin historik të popujve në Ilirik, në Mesdhe, etj. Derisa të tjerët nuk stepën në asnjë çast prej kuazi tezave e hipotezave mbi të cilat edhe në kohë të sotme ndërtojnë histori të rreme dhe mbi të krijojnë arsye hegjemoniste, ndër ne nismëtarët e atyktëshëm, bëheshin objekt talljeje, kinse atyre temave

iu ka kaluar koha. Një çështje që e pret këtë Departament e që deri me sot ka çaluar shumë, është bashkëpunimi i Departamentit me Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës, në mënyrë që në planprogramet e shkollave të mesme të futin lëndën e trashëgimisë kulturore si lëndë obligative. Kjo kërkesë që negociuar disa herë, por nuk u realizua dot. Një realizim i tillë do kishte reflektim pozitiv në prurje me të përgatitura të studentëve në vit të parë e sidomos kishte për zgjidhë njëherë e mirë punësimin për këtë profil, i cili ka ngelë si fëmiu pa prind, o për të ikur jashtë vendi, o për të kryer punë krahut e çfarëdo tjetër, ku me përbuzje rropaten nga kafiteri në tjetrën; nga një shitore në tjetrën për paga minimale, që s'arrin as sa lëmosha e një dite të një nevojliu që detyrohet shtrijë dorën në rrugëkryqet e Kosovës.

*A.C. Faleminderit profesor për intervistën. Departamenti ku keni punuar mbushi 20 vjetë dhe po rritet. Për fund, dy fjalë për këtë përvjetor.

U.Xh. Mendoj se ky përvjetor këtë Departament po e gjenë të konsoliduar, me të arritura të lakmueshme në punë dhe nxjerrjen e mbi 1000 të diplomuarëve, një numër jo i vogël i tyre MA, të tjerë në prag doktorate, por dhe të doktoruar në universite prestigjioze brenda e më shumë jashtë vendi.

Kur para 20 vitesh numronim në gishtërinjët e një dore kuadrot e këtij profili, sot kjo rritë na bën të ndihemi shumë krenar. Suksese për punë të mbara!

Nder dhe mision

[Intervistë me Nora Prekazi-Hoti/kuratore e pavijonit të etnologjisë në Muzeun e Mitrovicë dhe drejtoreshë në Fondacionin “Dhemetra”.]

*Z.H. A mund të ndash me ne, përvojën të cilën e ke pasur në Departamentin e Etnologjisë?

Isha pjesë e gjeneratës së katërt të Degës së Etnologjisë, dhe si studente isha e pasionuar me art pamor dhe me letërsi. Po ashtu më pëlqenin studimet rreth kulturës, teorive, reflektimeve mbi kulturën shqiptare e të rajonit, që më kanë zhvilluar si individ dhe si një profesioniste në fushë të etnologjisë. Kishte një rrjedhë organike, që e kaluam si gjeneratë: një afërsi mes nesh si kolegë, pastaj me profesorët, hulumtimet në teren, jetesa në Prishtinë, e përgatitjet e provimeve që i bënim si grup në banesën time me qira. Të gjitha ishin një eksperiencë shumë e bukur dhe e papërsëritshme. Kishim një ndjesi gati familjare thuajse me gjithë stafin akademik, sepse ekzistonte një pasion i pashlyer i themelueseve të kësaj dege për të çuar përpara punën akademike të Departamentit. Vlen të theksohet për mua se, në vitin e fundit kishte risi për ne si studentë, sepse në Departament erdhën edhe staf i ri, me qasje dhe vizione të reja, me të cilët kishim akoma më tepër mundësi për eksplorim të njohurive, të vetës si dhe mundësive kreative e bashkëkohore për t’iu qasur studimeve dhe të gjeturave tona.

*Z.H. Ju sot punoni në Muzeun e Mitrovicës, muze i cili është mjaft i suksesshëm me shumë aktivitete e shumë vizitorë - sa iu kanë ndihmuar studimet në punën tuaj?

Kur u punësova në Muze të Mitrovicës si etnologue, ishte pas një pauze disa vjeçare pas diplomimit në BA, por njohuritë ktheheshin pasi konfrontohesha me koleksione materiale të sektorit të etnologjisë, që është jashtëzakonisht i pasur në muzeun tonë. Gjithsesi vlen të theksoj se për mua kontaktet me profesorët e tonë si znj. Drita Statovci, z. Ukë Xhemaj, znj. Nita Luci, znj. Zanit Halimi, e profesorët tjerë kanë qenë dhe janë akoma shumë të afërta. Dhe, akoma janë të gatshëm për të ofruar konsultime, këshilla dhe burime. Së bashku kemi bashkëpunime profesionale e aktivitete të ndryshme. Për të qenë etnologue pranë një muzeu kaq të pasur në Kosovë, për mua ka qenë një ndër nderet dhe misionet më të mëdha që i kam përjetuar si profesioniste e kësaj fushe. Gjithsesi,



kemi akoma shumë për të bërë, për ta kthyer njohurinë tonë në qasje sa ma gjithëpërfshirëse, sa ma atraktive e inovative për vizitorë, hulumtues, nxënës e artdashës e qytetarë.

*Z.H. A keni ndonjë porosi për ata që dëshirojnë të studiojnë në Departamentin Antropologjisë?

Unë dëshiroj t'i motivoj ata që kanë pasion të hulumtojnë në fushën e antropologjisë kulturore dhe arkeologjisë, duke i inkurajuar se jemi të gjithë këtu nëpër institucionet tona, që të ju ofrojmë çfarëdo përkrahje, përvojë, apo edhe burimi që kemi mbledhur nëpër vitet e përvojave tona. Gjithsesi, duhet pasur parasysh se si degë kërkon që uria të mos ngopet kurrë, për të qenë kërkues, inovativ dhe me këmbë në tokë. Po e parafrazoj thënien e shumë përsëritur gjatë studimeve të profesoreshës Dritë, se etnologu/antropologu duhet jetë gjithmonë “Sy, vesh dhe gojë”... i hapur për të parë, i gatshëm për të dëgjuar si dhe të interpretojë në formë objektive dhe sa më interesante atë që ka mësuar/hulumtuar dhe gjetur.

Kandi i antropologjisë

Janjeva - një qytezë “gërmadhë” në braktisje e sipër

[Nga Jeta Salihu, studente e vitit të dytë, në antropologji kulturore]

Janjeva është vendbanim shumetnik, ku jetonin e jetojnë shqiptarë, kroatë, serbë, romë dhe turq. Ka qenë e njohur veçanërisht për xehetari (ari e argjend) e zejtari, për përpunim të metaleve e të plastikës, për artizanate, për tregti etj. Në Janjevë, për më se 700 vjet, ekziston komuniteti kroat të ardhur kryesisht nga Dubrovniku, të cilët i ndihmuan vendit mjaft shumë sa i përket pjesës ekonomike duke hapur miniera ari e argjendi.

Një karakteristikë e Janjevës së dikurshme ishin edhe bodrumet e shtëpive të cilat kroatët i kishin kthyer në vende pune ku zhvillonin zejtarinë e tyre: bënë enë, shporta e mjete të ndryshme nga plastika dhe tepsi e enë të tjera për gatim të cilat për bazë kishin bakrin ose aluminin. Me anë të këtyre veprimtarive vendit iu ngrit gjendja ekonomike sepse bënë tregti me qytetet të tjera.

Fatkeqësisht, në vitin 1991 kroatët u arratisën nga Janjeva, e madje edhe nga Kosova, nga okupatorët e asaj kohe. Kjo rezultoi që vendi të kalonte në një gjendje të rëndë ekonomike. Këtë gjendje arritëm të shohim edhe ne studentët e Departamentit të Antropologjisë, gjatë vizitës studimore që i bëmë Janjevës, në maj të këtij viti. Gjendja jo e mirë ekonomike vërehej nga shtëpitë e banueshme dhe ato të braktisura. Shumë të rinj e shumë familje kishin lënë vendin duke shkuar drejt Europës dhe shpërngulur në Kroaci, e shtëpitë e tyre kishin mbetur ashtu siç i kishin lënë: të zbrazëta, shumë prej tyre pa dyer e pa dritare, mure të vjetra, mure të thyera, etj. Banorët e mbetur në Janjevë jetonin në shtëpi pak a shumë të ngjashme të cilat të lenin përshtypjen se nuk ishin në gjendje dhe aq të mirë, kur i shikoje nga jashtë. Janjeva duket se është në braktisje e sipër, për të mbetur një qytezë gërmadhë.

Ne shkuam edhe tek oborri i shkollës fillore në Janjevë dhe intervistuar disa fëmijë dhe një gjyshe, e cila po merrte nipin e saj nga shkolla. Fëmijët që intervistuar ishin fëmijë nga klasa e 5-të deri në klasën e 7-të. Djemtë shoqëroheshin me shokë e vajzat me shoqe. Pyetjes se sa u pëlqente jeta në Janjevë disa iu përgjigjeshin me entuziazëm e disa thoshin se ditët e tyre ishin ditë të za-



Vizitë në pazarin e Janjevës

konshme, me rutinat e njëjta, të cilat nuk i tregonin me shumë qejf në fytyrë. Rutina e djemve të asaj moshe, të cilët i intervistuar, ishte të shkonin në shkollë çdo ditë, të luanin me top pas mësimit ose gjatë ditës, të shkonin në shtëpi dhe pastaj të dilnin me shokë ose të luanin lojëra kompjuterike. Për vajzat e intervistuar, rutina ishte mësimi në shkollë, ndërsa pas mësimit shkonin në shtëpitë e tyre dhe iu ndihmonin nënave me punët e shtëpisë. Kurse zonja e cila pranoi të fliste me ne, na tregoi se, katër nga gjashtë fëmijët e saj kishin emigruar drejt Europës për një jetë më të mirë dhe për të siguruar të ardhura për familjen, ashtu si shumë të rinj të familjeve të tjera. Zonja me shumë dhimbje i kujtonte kohërat e vjetra, e për të tashmen na tregonte se iu mungonin edhe gjërat elementare si uji. Të gjithë këto i kam shënuar më hollësisht në fletoren time të terrenit.

Monumente të rëndësishme të Janjevës ishin Kisha e Shën Nikollës dhe shtëpia e At Shtjefën Gjeçovit, ndonëse kjo e fundit dukej e braktisur. Rëndësi shumë të madhe për banorët kishte edhe Teqja që gjendej pak më në periferi, ku zhvillohen rituale tek varri i shehut të fshatit që gjendej brenda, të cilën e vizituar edhe ne



Duke diskutuar për kujtesën dhe harresën, trashëgiminë kulturore dhe ekonominë

gjatë vizitës studimore dhe morëm shumë shënime.

Janjeva, gjithashtu, kishte një zyrë të vogël aktive, në qytet, e cila drejtohej nga një grup njerëzish ku organizoheshin aktivitete të ndryshme në të cilat mund të merrnin pjesë banorë të të gjitha etnive pa përjashtim. E njëjta zyrë kishte organizuar kurse për mosha të ndryshme, ku mund të vijonin mësimet për gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë angleze etj. Për nënat të cilat vijonin mësimet në kurs ishte krijuar mundësia t'i regjistronin fëmijët e tyre në kopshtin e fëmijëve dhe t'i lenin aty gjatë kohës që ishin duke mësuar. Kopshti ishte krijuar nga po ajo zyrë që organizonte aktivitetet e kurset. Kopshti kishte një mësuese shqiptare dhe një rome, për shkak që fëmijët të mos kenë probleme me komunikim gjatë kohës që janë në kopsht.

Ishte një vizitë mjaft e mirë dhe e nevojshme për ne si studentë të antropologjisë. Pamë dhe mësuam për kultura

e zakone të etnive të ndryshme dhe patëm rastin të intervistoni e të mësonim për kulturën e sjelljen e zakonshme të tyre. Pamë se çfarë do të thotë të jetosh në një qytet që dikur kishte emër e prosperitet, ndërsa sot ka vetëm gërmadha e pak shpresë për të ndërtuar jetë të re.

Veshja e Hasit - vizitë në terren

[Miridonë Sylja, studente e vitit të dytë në Antropologji Kulturore]

Gjatë vitit të dytë të studimeve në degën e Antropologjisë Kulturore ligjërohen disa nga lëndët më të rëndësishme. Viti 2020, fatkeqësisht, ka qenë vit i cili ka sjellë ndryshime në të gjitha aspektet jetësore në shoqëri. Meqenëse pjesë e saj ka qenë edhe mësimi online, për studentët ka qenë një eksperiencë e re dhe e vështirë. Gjatë vitit 2020 puna në terren ka qenë sfidë për ne për t'i praktikuar metodat dhe teknikat e hulumtimit në këtë fushë.

Lëndët që janë ligjëruar gjatë vitit të dytë të studimeve kanë qenë “Metodat dhe teknikat e hulumtimit”, “Teoritë antropologjike”, “Antropologjia urbane”, “Veshja dhe identiteti” dhe “Antropologji e ushqimit”. Tek lënda “Metodat dhe teknikat e hulumtimit” ka qenë e nevojshme që ato metoda dhe teknika që i kemi mësuar në teori t'i praktikojmë në terren. Po ashtu, edhe tek lënda “Veshja dhe identiteti”, njohja me veshjet tradicionale shqiptare dhe të vendeve tjera në botë na e ka shtuar kureshtjen për t'i parë dhe studiuar nga afër disa prej tyre. Ishim me fat që pas lehtësimit të masave kundër virusit COVID-19 dhe përfundimit të periudhës së ligjëratave të bëjmë vizita studimore në disa qytete të Kosovës, të cilat pas vetes përmbajnë histori dhe pasuri kulturore shumë të çmuar. Punën në terren e kemi zhvilluar në qytetin e Mitrovicës, Janjevës dhe në Has të Prizrenit. Po ashtu kemi pasur vizita në Prishtinë me znj. Linda, punuese e veshjeve popullore dhe në Muzen Kombëtar të Kosovës, ku kemi vizituar depon e sektorit të etnologjisë, për të parë veshjet aty. Gjatë këtyre vizitave studimore ne jemi munduar të shohim jetën që zhvillohet në këto qytete, të njohim njerëzit aty dhe të identifikojmë veshjet popullore të vendit tonë.

Vizita jonë e fundit ka qenë në Has, në fshatin Zym dhe Gjonaj. Në këto dy vende kemi pasur rastin të identifikojmë dhe të shohim nga afër disa nga veshjet e tyre tradicionale. Janë fshatra jo shumë larg nga njëra tjetra, mirëpo kanë dallime në veshjet e tyre. Në Zym na ka mikëpritur zonja Lajde Kolgjeraj, e



Pjesë e koleksionit të znj. Lajde Kolgjeraj në Zym, Has

cila është koleksionuesja e vetme e veshjeve tradicionale të Zymit. Në shtëpinë e saj kemi parë të gjitha veshjet: nga veshja e plakave deri tek vajzat e reja. Ne e dëgjua me shumë kujdes duke e shpjeguar procesin e koleksionimit të tyre. Veshjet tradicionale nuk mund t'i shohim të veshura nga gratë apo burrat e këtij fshat, sepse ato tashmë kanë mbetur për t'u ekspozuar vetëm në festivale apo në raste të martesave, por për fat të mirë ato promovohen në shfaqjet e Ansambllit etno-kulturor 'Katarina Josipi'. Duke qenë pjesëmarrëse e festivaleve të ndryshme, zonja Lajde na ka treguar se disa nga veshjet e saj huazohen nga ansambli dhe kthehen prap tek ajo kur shfaqjet përfundojnë. Momentin kur kam parë veshjet e Zymit të ekspozuara në dhomë, ka qenë një ndjenjë që jo shumë lehtë mund të përshkruhet, sepse interesi im për të studiuar kostumet tradicionale në të ardhem më dha shpresë, që ato ende kanë mundësi të studiohen dhe të mirëmbahen nga njerëz që duan traditën dhe kulturën, siç ka vepruar zonja Lajde Kolgjeraj. Kam qenë me fat që edhe të vesh një nga të gjitha veshjet tjera të Zymit. Karakteristikat e këtyre veshjeve janë ngjyrat e ndezura në të, simbolet që e përbëjnë atë dhe shtresat e shumta që kanë ato.



Duke provuar punën në vek, Gjonaj/Has

Ndërsa në Gjonaj kemi pasur rastin të takohemi me zonjën Taibe Agushaj e cila na mikpriti me shumë dashuri dhe pa hezitim, për të na e shpjeguar procesin e qepjes së veshjes. Zonja Taibe ende e përdorte vekun dhe po e ruante me shumë kujdes dhe e quante jeta e saj. Aq bukur na e ka shpjeguar mënyrën se si përdoret veku dhe rëndësinë e saj, sa ndjeheshim në faj, që nëse këto zakone nuk përcillen dhe nuk mësohen nga gjeneratat e reja, ato do të zhduken. Pos shpjegimit të përdorimit të vekut, ajo na e ka shpjeguar edhe procesin e qepjes së pjesëve të veshjes. Veshja e fshatit Gjonaj ende vishet nga disa gra të moshuara dhe zonja Taibe ende i qepë veshjet tradicionale të nuseve në vek, për nuset e reja. Veshja tradicionale e këtij fshati karakterizohet nga penjët shumëngjyrësh, nga rruazat e shumta që shkëlqejnë dhe nga simbole e motive të ndryshme.

Nga vizita studimore në Has kemi marrë një përvojë të re dhe shumë të vlefshme. Një përvojë e tillë na ka ndihmuar që të ambientohemi më lehtë me punën në terren, të mësohemi se si të kemi qasje më adekuate me njerëzit e vendit që do vizitojmë dhe, na ka përgatitur për vizitat studimore që do t'i kemi në të ardhmen si etnografë. Vizitat e tilla në terren janë dëshmi e nevojës së madhe për të dokumentuar veshjet dhe në përgjithësi traditën e veshjeve në vende të ndryshme në Kosovë, si



Në punëtori të veshjeve të znj. Agushaj, në Gjonaj të Hasit

tregues shumë i mirë i ndryshimeve dhe ngjashmërive kulturore, ndër vende dhe kohë të ndryshme. Kjo do të shërbente që, po ashtu, të dokumentojmë dhe ruajmë një pjesë të rëndësishme të identitetit tonë kulturor e social.

Vështrim etnografik nga ekspedita hulumtuese “Evidentimi dhe dokumentimi i vlerave shpirtërore të kullave”

Valentina Krasniqi, absolvente në Departamentin e Antropologjisë



“Çka me fol unë kur kulla flet vetë”, ka qenë njëra prej fjalive që e kam dëgjuar më së shpeshti gjatë realizimit të intervistave në kuadër të projektit “Evidentimi dhe dokumentimi i vlerave shpirtërore të kullave”. Dëshira ime e kahershme, që të shoh një kullë për së afërmi u shndërrua në realitet, falë këtij projekti. Së bashku me kolegët/koleget dhe mentorët, për gjashtë ditë radhazi arritëm të lundrojmë nëpër historinë tonë shqiptare. Të bashkuar i bëmë ballë

çdo dallge që terreni na e servoi. Isniqi e Drenoci i Deçanit, Nivokazi i Gjakovës dhe Juniku ishin vendet që zgjodhëm për të bërë hulumtimin etnografik. Atje e pashë që historia, triumfet dhe rrënojat e së kaluarës janë shumë pranë njëra-tjetrës, bashkëjetojnë, preken e rrëfohen si kujtesë e gjallë. Kullat e gurta, sado që duken të harruara e të neglizhuara, prapë se prapë paraqesin krenari. Brenda dhe rreth tyre thjesht jetohet! Për to tregonin mjaft rrëfime dhe secila kishte historinë e

saj të veçantë. Natyrisht, kishte edhe shumë gjëra që dëgjova për herë të parë. Më pëlqente kur dëgjoja secilin më krenar se tjetri, duke thënë se kulla e tij është me e mira dhe më e vjetra. Gjithmonë e ceknin se aty “janë pedat punë t’mdhaja historike” dhe ato kanë luftuar vetë. Çuditësha, e shumë shpesh e shihja veten duke imagjinuar për rrëfimet që na i thoshin bashkëbiseduesit. Mahnitesha edhe me mënyrën se si ata na pranonin në shtëpinë e tyre, pa hezituari fare. Kishte raste edhe nëse nuk jetonin më

në kullë, një praktikë të rëndësishme të vlerave shpirtërore e kishin bartur deri në ditët e sotme, atë të mikpritjes. Nuk kam rastisur të takoj dikë e të mos flet për kullën e vet. Ka pasur edhe momente kur nipër e mbesa janë ulur dhe kanë dëgjuar gjyshin dhe gjyshen e tyre, teksa flisnin për kullën që e kishin në oborr. Zëri iu dridhej, lotët iu pikonin, sytë iu shkëlqenin dhe mishi iu tërqethej teksa kujtonin kohën e të jetuarit në kullë. Ndërsa unë në ato momente e kuptoja rëndësinë e madhe që kulla kishte për ta. E kuptoja që të bërit etnografi dhe të dëgjosh rrëfimet e së kaluarës janë copëza magjie që vetëm fusha e antropologjisë na falë. Po ashtu, kuptoja që bota e sotme është me më pak ngjyra dhe më pak interesante se sa që ishte në të kaluarën.

Më duhet ta pranoj që, secila intervistë ka qenë sfidë në vete. Të ndarë në grupe, duke ecur rrugëve në një vend që nuk e njihnim aspak dhe, duke u ballafaquar me temperatura të larta, vazhdimisht ishim në kërkim të kullave. Sa gëzoheshim kur e takonim edhe dikë që na rrëfen për të! Shpejt koordinoheshim për punën që do e merrnim përsipër. Njëri bënte intervistën e tjetri asistonte me fotografitë. Ka pasur edhe të tilla raste që kemi pritur deri kur bashkëbiseduesi është kthyer nga bjeshka, e dikush tjetër nga puna në fushë. Puna në terren fillonte n'dritë e nganjëherë përfundonte kur erësohej. Së fundmi, ky projekt, përpos që më përgatiti profesionalisht me përvojat e fituara, më solli edhe përmbushje shpirtërore në dy aspekte. E para, gjatë kohës kur ishim në fshatin Drenoc përjetova ndjenjën e të jetuarit në kullë. Të qëndruarit në konakun e gurtë, të fjeturit në odë, e të ngrënit ushqimet tradicionale, më dukej sikur po më afronte akoma më tepër me kullat e tjera dhe protagonistët e tyre. Ndërsa e dyta



Valentina Krasniqi në veshjen e Hasit

është veshja e kostumit hasjan. Gjatë kohës kur isha në Deçan, kur përfunduam punën në terren, papritur dhe pa përtuar fare e veshja kostumin e Hasit. Kostum të cilin e kishte sjellë me vete kolegja ime, Arlinda Shatri. Të punuara n'vek e n'dorë para dyzetë viteve nga gjyshja saj, Tixha Shatri. Çdo detaj i tyre më la mbresë, e sidomos këmisha e qëndisur bukur rreth e përqark grykës. Kromatika e ngjyrave, dominimi i së kuqes dhe mënyra e mbulimit të kokës, zgjonte kërshtëri, jo vetëm tek unë por edhe tek të gjithë kalimtarët

që ndaleshin dhe më shikonin me habi, teksa unë po realizoja disa fotografi. Me u kthi prej statusit të studentes në rolin e nuses hasjane për ca minuta mbetet një prej kujtimeve më të bukura për mua. Nuk kanë për t'u harruar edhe shumë gjëra të tjera që i përjetova dhe mësova gjatë punës në terren. Vullneti dhe çiltersia e bashkëbiseduesëve kur rrëfenin, na motivonte që ne të thurim një rrjetë shprese për të ardhmën e kullave. Le të jetë ky projekt nistar që ato t'i ruajnë me delikatesë dhe të jemi krenarë për ekzistimin e tyre.

Alumni

Lekë Shala

[Lekë Shala është student i masterit në programin “Arkeologji parahistorike”, Universiteti i Gjenevës, Zvicër. Leka ka mbaruar studimet në drejtimin arkeologji (2016-2019) në Departamentin e Antropologjisë/Fakulteti Filozofik/UP. Studimet e tij MA financohen pjesërisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në marrëveshje specifike me UP-në, për vazhdimin e studimeve antropologjike/arkeologjike për studentët e dalluar]

Studimet jashtë vendit në një qytet siç është Gjeneva kanë hapur shtigje të reja në pikëpamjen time mbi problematikat e ndryshme arkeologjike. Ato erdhën në kohën e duhur, kur përvojat dhe njohuritë e mëherëshme në Kosovë kanë ndier nevojën për një rifreskim, duke lexuar libra, njoftuar njerëz dhe parë qasje të reja për të më frymëzuar të vazhdoj më tutje. Universiteti i Gjenevës, një universitet me traditë qindra vjeçare ofron literaturë, gati të pakufishme, që nuk mund ta përthekosh. Duke e ditur se dija është e tillë, këtu punohet pandërprerë për të prodhuar dije të reja. Asgjë nuk ka përfunduar sa i përket njohurive, ky është rregulli numër një, i pa shkruar dhe që asnjëherë nuk thuhet, por ndjehet dhe të godet fort, në çdo cep të universitetit, në hapësirat e përbashkëta, ku, mbizotëron një frymë e këndshme shoqërimi.

Muzetë e pasur të ofrojnë një oqean informatash përmes artefakteve të mbledhura me kohë, e më e bukura është kur gjen ndonjë grimcë të kulturës tënde në mes një laramanie qytetërimesh e kulturash njerëzore, siç janë fotografitë e filmim shekullit XX nga Fred Boissonnas, ku shihen burrat arvanitas duke pushuar poshtë një peme, fotografi këto të ekspozuara në Muzeun e Artit në Gjenevë. Shpesh mendoj për arvanitasit, fytyrat e të cilëve, mes gjithë atyre fotografive të njerëzve e vendeve nga Evropa, Afrika e Azia,



të lënë përshtypjen se ndihen sikurse unë, një student nga Kosova në njërin nga qytetet më ndërkombëtare në Evropë – kureshtar, por edhe shumë krenar.

Mësimi i një gjuhe tjetër përveç asaj angleze, po ashtu është diçka shumë e nevojshme në formimin akademik, për më tepër hap horizonte të reja bashkëpunimi. Ndërthurja e shkencave natyrore në arkeologji është më aktuale se kurrë, një qasje e tillë është kusht për studime të mirëfillta arkeologjike. Me qenë se Dega e Arkeologjisë Parahistorike në Universitetin e Gjenevës është nën strehën e shkencave natyrore, dita-ditës po e ndjej një përmbushje në këtë drejtim, sidomos gjatë punës në laboratorët që ofrojnë mundësinë e përdorimit të qasjeve biologjike, kimike dhe arkeometrike. Sigurisht

kjo është arritur si rezultat i një procesi të gjatë, i ndërthurur me krijimin e kushteve të nevojshme dhe punës së tyre të përbashkët, rrugë që duhet ndjekur.

Kosova ka shumë për t'i dhënë trashëgimisë botërore, studentët e antropologjisë në Prishtinë duhet të punojnë dhe besojnë në punën e tyre, duke shfrytëzuar shtigjet e hapura nga ata para tyre, duke pas parasysh se terreni është i virgjër dhe ka shumë për të njohur, ndonjëherë edhe përmes studimit jashtë vendit, duke shfrytëzuar mundësitë e shoqërimit me njerëz të fushës, vizita në muzetë e mëdha dhe duke u shpërlarë nga ndotjet e politikave ditore, shpesh herë keqdashëse, për një përqendrim në atë se çfarë është me rëndësi – zgjerimi i diturive në atë që të ofron kënaqësi, rrugë kjo që për mua nisi gjatë studimeve të mia në Kosovë.

Kaltrina Igrishta

[Kaltrina Igrishta është studente e masterit në programin “Arkeologji parahistorike”, Universiteti i Gjenevës, Zvicër. Kaltrina ka mbaruar studimet në drejtimin arkeologji (2016-2019) në Departamentin e Antropologjisë/Fakulteti Filozofik/UP. Studimet e saj MA financohen pjesërisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në marrëveshje specifike me UP-në, për vazhdimin e studimeve antropologjike/arkeologjike për studentët e dalluar]

Dëshira për t'i zgjeruar njohuritë në antropologji-arkeologji dhe ëndrra për të rikonstruktuar jetën e para-dardanëve e të dardanëve m'ka magjeps për me gjet' rrugë mësimi. Jam ndjerë shumë e përmbushur kur kuptova se jam pranuar në Universitetin e Gjenevës, ky i fundit me traditë universitare që nga viti 1559. Koha kur fillova studimet MA këtu ishte koha më e mirë për mua, për me pa një anë tjetër të studimit të arkeologjisë parahistorike, e njohuritë nga leximet me i praktiku në llojllojshmëri të mënyrave të studimit. Meqë fusha e arkeologjisë parahistorike gjendet në Fakultetin e Shkencave Natyrore, çdo studim arkeologjik është i bashkë-lidhur me analizat biologjike, kimike, gjeologjike, sedimentologjike, dendrokronologjike, flourimetrike, izotopike, e shumë analiza të tjera. Metodologjia e punës e këtij fakulteti, si mundësia për qasje në laboratore, pjesëmarrje në konferenca shkencore arkeologjike, për punë në gërmime arkeologjike të karakterit ndërkombëtar, e veçojnë këtë universitet, dhe mua si studente më ofrojnë shumë për zhvillimin tim akademik.

Gjatë studimeve Bachelor jam përpjekur që të përcaktoj se cilës degë të antropologjisë i përkas, ku, leximet e mia gjithmonë kanë anuar kah paleoantropologjia, arkeologjia kognitive, petrografia e petrologjia, e përherë pikëpamja emike dhe “chaîne opératoire” më intrigonin drejt përndritjes të së kaluarës njerëzore, më anë të interpretimeve antropologjike e sociologjike. Duke




u thelluar në këto lexime, më erdhi mundësia gjatë studimeve Master përmes punës t'i kthej në jetë të gjitha njohuritë e përmbledhura deri më tani, e dita-ditës ta plotësoj mozaikun e diturisë.

Një anë shumë e rëndësishme e zhvillimit të karakterit studiues është gjuha, ku gjuha frënge është duke e luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin tim shkencor. Gjuhët e botës perëndimore janë fillesat për kuptimin e shkencave, e veçanërisht shkencës së arkeologjisë, mbi të cilën janë të botuara me qindra mijëra studime, të përgjithshme e shumë konkrete, që për ne si studentë janë elementare për të kuptuarit dhe për mbamendjen në këtë fushë studimi. Në të ardhmen shpresoj që ne studentët t'i thellojmë njohuritë tona gjuhësore dhe përveç anës së studimit në të cilin do të specializohemi, të kontribuojmë në fushën përkthimit të librave dhe

artikujve me karakter arkeologjik, që studentët fillestarë në këtë fushë të kenë mundësi qasjeje në studimet botërore edhe përmes gjuhës shqipe.

Rrugën e mësimit të së kaluarës njerëzore të cilën e nisa Kosovë, më ka përgatitur e inspiruar për “ta gurrar gurin në gurin” në drejtim të përndritjes së arkeologjisë, e sot jam duke e vazhdu atë nismë që më përmbush shpirtërisht dhe intelektualisht.



Fatbardha Hoxha

[Fatbardha Hoxha, studente e masterit në programin “Arkeologji parahistorike”, Universiteti i Gjenevës, Zvicër. Fatbardha ka mbaruar studimet në drejtimin arkeologji (2016-2019) në Departamentin e Antropologjisë/Fakulteti Filozofik/UP. Studimet e saj MA financohen pjesërisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në marrëveshje specifike me UP-në, për vazhdimin e studimeve antropologjike/arkeologjike për studentët e dalluar]

Ky është viti im i parë në studimet MA në Departamentin i Arkeologjisë në Universitetin e Gjenevës në Zvicër. Jam në Fakultetin e Shkencave, ku ekziston Departamenti i Biologjisë e Kimisë. Ndonëse kalimi prej shkencave shoqërore, përkatësisht antropologjisë/arkeologjisë në Fakultetin Filozofik/UP, në studime ku gërshetohen shkencat ekzakte, ka qenë një tranzicion, për mua ka qenë dhe është një përvojë mjaft e mirë.

Sa i përket lëndëve po mundohem të ndjek shumë sosh në mënyrë që të formoj një dije të përgjithshme në disa fusha të tjera të arkeologjisë, sidomos asaj që ka të bëjë me biologjinë e kiminë. Paralelisht ndjekjes së ligjëratave, jam duke punuar në tezën e masterit, e cila mbikëqyret nga Qendra Universitare e Medicinës Legale në Llozanë dhe Universiteti i Gjenevës.

Gjatë studimeve këtu kam marrë mësimet e para të paleoantropologjisë, të cilat më kanë zgjuar një kureshtje të madhe për të studiuar më tej për këtë degë, ndoshta për shkak të mungesës së profilit të paleoantropologjisë gjatë nivelit bachelor ose ndoshta sipas fjalëve të paleopatologes angleze Charlotte Roberts se mbetjet humane gjithmonë shfaqin më shumë interes apo tërhiqen



nga të tjerët: “ne të gjithë posedojmë një skelet dhe duket se dëshirojmë të dimë më shumë për të”.

Prandaj për finalizim të masterit kam zgjedhur të fokusohem në bioarkeologji e të punoj në metodologji për determinimin e seksit biologjik tek skeletet dhe aplikimin e saj në arkeologji duke përdorur mënyra virtuale si skanimi CT dhe skanimi 3D i sipërfaqes, duke e pasur parasysh se, me zhvillimin e teknologjisë njëkohësisht edhe arkeologjia po evoluon. Një gjë tjetër që po më bind më shumë rreth kësaj është se, studimi i mbetjeve mortore nuk njih kufi të periudhave kohore në arkeologji, që do të thotë jam çli-

ruar nga kjo pjesë.

Se sa kemi ecë deri tani po na mban fort përgatitja nga studimet në Departamentin e Antropologjisë në Kosovë e me shpresë që do t'i mbajë edhe të tjerët.



Merita Beqiraj

[Merita Beqiraj rrëfen për studimet e saj në arkeologjinë mesjetare si doktorante në dy universitete evropiane. Merita ka qenë ndër studentët e parë të programit BA në arkeologji në Departamentin e Antropologjisë, program ky i hapur më 2014]

Unë jam Merita Beqiraj dhe vij nga Suhareka. Kam qenë studente e gjeneratës së parë e Departamentit të Antropologjisë, në drejtimin e arkeologjisë. Konsideroj se jam rritur dhe krijuar së bashku me Departamentin. Kjo padyshim ka ardhur si pasojë e një përkushtimi dhe dashurie të pakusht që kam për arkeologjinë. Natyrisht, ky përkushtim dhe kjo dashuri shpesh janë sfiduar nga vështirësitë që sjell jeta dhe profesioni - por kjo është jeta, kjo është arkeologjia. Pikërisht për këto sfida, shumëkush mendon se arkeologjia nuk është për femra. Me shembullin tim dua t'ju tregoj të gjithë atyre vajzave të reja që synojnë të fillojnë studimet se arkeologjia është profesioni më i jashtëzakonshëm që ato mund ta ëndërrojnë. Nuk kam se si ta harroj ditën e fundit të ligjëratave në Universitetin e Prishtinës dhe dua ta ndaj me studentët e rinj. Profesoresha ime, Edi Shukriu, figura më markante e të gjitha epokave në arkeologjinë kosovare, e gëzuar nga suksesi im, dhe pasi kishte marrë vesh se do vazhdoj studimet për Master jashtë vendit, më dhuroi një libër dhe më tha: si femër do të paragjykoresh e gjykoresh, do të anashkalohesh e nënvlerësohesh, këto po t'i them nga përvoja ime, por kurrë mos u dorëzo! Dua ta falënderoj për zemërsisht për kurajën, dhe t'i them që pavarësisht vështirësive unë nuk jam dorëzuar.

Sot, si një arkeologe e diplomuar, si një femër e pavarur, vazhdoj që të jem në kërkim të dijeve dhe njohurive të reja në fushën e arkeologjisë. Pas përfundimit të nivelit Master në Hungari, me temën Vendbanimet



e fortifikuara dhe kishat e mesjetës së hershme në Kosovë vendosa që studimet t'i vazhdoj në nivelin e doktoratës. Meqë nuk po gjeja bursë për vazhdimin e doktoratës vendosa të aplikoj në disa kompani e institucione evropiane të cilat merren me arkeologji. Më priu fati dhe kërkesën time e pranoi kompania prestigjioze gjermane ArchaeoConnect, me bazë në Tübingen. Kam filluar para një viti dhe kjo kompani më ka dhënë mundësi financiare që të vazhdoj studimet e doktoratës në dy universitete njëkohësisht, në Eberhard Karls University of Tübingen (Gjermani), me temën Qeramika mesjetare në Kosovë, dhe në Pázmány Péter Catholic University (Hungari) me temën Vendbanimet e fortifikuara kodrinore të antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në Kosovë si dhe prezenca e kishave në këto vendbanime.

Deri më tani faza tranzitore e kalimit nga antikiteti i vonë në Mesjetën e hershme në Kosovë është ende në hapat fillestar të studimit dhe studimi dhe thellimi i njohurive në këtë drejtim është i nevojshëm dhe i mirëseardhur.

Këto arsye e të tjera më kanë shtyrë të merrem me mesjetën e hershme, qeramikën mesjetare dhe veçanërisht me vendbanimet kodrinore dhe kishat Intra muros. Po ashtu, unë jam shumë e lidhur dhe e pasionuar pas studimeve mesjetare dhe Kosova ka mungesë të specialistëve që merren me mesjetën e hershme.

Pos studimeve të mia të doktoratës unë vazhdoj që të jem mjaft aktive në ushtrimin e profesionit tim. Kjo falë punës sime shumë aktive në kompaninë ku punoj. Përpos përnjohjeve në terren, teknikave të gërmimit, dokumentimit të materialit arkeologjik etj., unë jam e përfshirë në përdorimin e disa teknologjive më të përparura që sot përdoren në arkeologji, si GPS (Global Positioning System), dronëve, Lidar, përdorimin e teodolitëve digjitalë me laser etj. Në anën tjetër jam duke punuar për krijimin e bashkëpunimeve në fushën e arkeologjisë në mes Kosovës dhe Gjermanisë. Jam shumë optimiste për projektet e ardhshme që mund të bëhen në vendin tim dhe për arkeologjinë e vendit tim.

Elena Rexha

[Elena Rexha ka qenë studente e drejtimit “Arkeologji” në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, UP. Aktualisht është studente e vitit të parë në nivelin MASTER në École Normale Supérieure, Paris, Francë dhe bursiste e Qeverisë Franceze. Pjesëmarrëse në një sërë projektesh/hulumtime në lokalitetet arkeologjike si: Ulpianë, Novobërdë, Barilevë, Dresnik, Vendenis, Keçekollë etj.]

3 vite bachelor, 3 vite mësim, punë, angazhime, emocione dhe kënaqësi. Këto vite i kalova në Departamentin e Antropologjisë, gjegjësisht në Fakultetin Filozofik – Universitetin e Prishtinës. Interesimi im për të vazhduar studimet në këtë fushë buron qysh në fëmijërinë time. Pata fatin të rritem në një ambient të rrethuar me literaturë dhe me specialistë të fushës. Periudha e studimeve bachelor është një pjesë shumë e rëndësishme e imja. Departamenti i Antropologjisë më ofroi njohuri, konsultime dhe njohje me persona të rëndësishëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Përveç diskutimeve në ligjërata, pata mundësinë që të bashkëbisedoj në konsultime me të gjithë profesorët e departamentit. Ndihesha me fat sepse kisha rastin të punoja me studiues shumë bashkëpunues. Shfletimi dhe studimi i literaturës dhe autorëve zhvillohej nëpër sallat e Fakultetit Filozofik.

Ndërsa, një pjesë mjaft e mirë gjatë 3 viteve ishte puna praktike, njëherësh pjesa më emocionuese për mua. Falë bashkëpunimit që ka Departamenti i Antropologjisë me Institutin Arkeologjik të Kosovës, unë isha pjesë e ekipeve në shumë përnjohje dhe gërmime arkeologjike të kryera në Kosovë së bashku me grupe profesionale arkeologësh. Ndihem përherë



falënderuese ndaj Prof. Ass. Dr. Arben Hajdarit, i cili më qëndroi pranë gjatë gjithë rrugëtimit tim dhe mbështetja e tij vazhdon ende.

Vazhdimi i studimeve në Paris për mua është një ëndërr e bërë realitet. Tani, jam në vitin e parë të studimeve MASTER në École Normale Supérieure (ENS) në Paris, një ndër universitetet më prestigjioze në Francë dhe jo vetëm. Fokusi im gjatë këtyre dy viteve të masterit bie te monumentet e krishtera gjatë periudhës mesjetare në territorin e Dardanisë Antike. Pa dyshim, që këtë temë pres ta zgjeroj dhe hulumtoj më hollësisht në studimet e mia vijuese. Jam e nderuar, shumë e lumtur dhe

falënderuese që kam rastin të punoj me studiues ndërkombëtar, njerëz të mrekullueshëm siç është mbikëqyrësi i temës sime, njëherësh drejtor i laboratorit AOROC në ENS Prof. Christophe Goddard.

Edhe pse po jetojmë në një vit ku pandemia na ka bllokuar dhe ngadalësuar në shumë aspekte, unë po e shijoj jetën në Paris. Qasja në laboratorin AOROC, bibliotekat fantastike të universitetit, konsultimet dhe bashkëpunimet me profesorët e “Département Sciences de l’Antiquité - ENS” janë vendet dhe momentet që unë vlerësoj më shumë.

Departamenti i Antropologjisë ofron
studime të nivelit BA në antropologji
(180 ECTS kredite, 3 vjet)

Studimet profilizohen në dy degë:

- a) antropologji kulturore
- b) arkeologji

Viti i parë akademik është i përbashkët,
ndërsa në vitin e dytë studentët ndjekin
profilin e zgjedhur. Departamenti shquhet për mundësinë
që u jep studentëve në punë praktike dhe projekte
hulumtuese.

Për më shumë, lexoni doracakun për
studentë, në uebfaqen e Departamentit
të Antropologjisë
<https://filozofiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,66>

ose na shkruani në
antropologjia@uni-pr.edu



